



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.42

26 prill

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 37/2012 datë 5.4.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare “Për thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave doganore”, bërë në Kyoto më 18 maj 1973 (e ndryshuar).....	2259
Ligj nr. 38/2012 datë 5.4.2012	Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor.....	2280
Rezolutë e Kuvendit datë 5.4.2012	Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Prokurimeve për vitin 2011.....	2297
Dekret nr. 7379 datë 9.4.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2298

LIGJ
Nr. 37/2012

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE
“PËR THJESHTIMIN DHE HARMONIZIMIN E PROCEDURAVE DOGANORE”, BËRË NË
KYOTO MË 18 MAJ 1973 (E NDRYSHUAR)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën ndërkombëtare “Për thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave doganore”, bërë në Kyoto më 18 maj 1973 (e ndryshuar).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.4.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7408, datë 23.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONVENTA NDËRKOMBËTARE
MBI THJESHTIMIN DHE HARMONIZIMIN E PROCEDURAVE DOGANORE
(e ndryshuar)
Këshilli i Bashkëpunimit Doganor
(Organizata Botërore e Doganave)
Rue du Marche 30
B-1210 Bruxellés
SHTOJCA I

HYRJE

Palët kontraktuese të kësaj Konvente të mbledhura nën mbikëqyrjen e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor,

në përpjekje për të eliminuar konfliktet midis procedurave dhe praktikave doganore të palëve kontraktuese që mund të pengojnë tregtinë ndërkombëtare dhe shkëmbimet e tjera ndërkombëtare;

me dëshirën për të kontribuar në mënyrë efikase në zhvillimin e tregtisë dhe shkëmbimeve të tilla, duke thjeshtuar dhe harmonizuar procedurat e praktikave doganore dhe duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar;

duke vërejtur se përfitimet kryesore të lehtësimit të tregtisë ndërkombëtare mund të arrihen pa rrezikuar standardet e kontrollit doganor;

duke pranuar se ky thjeshtim dhe harmonizim mund të realizohet në veçanti nga zbatimi i parimeve të mëposhtme:

- zbatimi i programeve që synojnë modernizimin e vazhdueshëm të procedurave dhe praktikave doganore dhe për rrjedhojë, rrisin efikasitetin dhe efikasitetin;



- zbatimi i procedurave dhe praktikave doganore në një mënyrë të parashikueshme, të vazhdueshme dhe transparente;
 - dispozita për palët e interesuara për të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me ligjet, rregullat, udhëzimet administrative, procedurat dhe praktikat doganore;
 - miratimi i teknikave moderne si menaxhimi i riskut dhe kontrollet me bazë auditit, dhe përdorimi maksimal i zbatimit të teknologjisë së informacionit;
 - bashkëpunim me autoritet e tjera kombëtare, administratat e tjera doganore dhe komunitetet tregtare, nëse është e përshtatshme;
 - zbatimi i standardeve përkatëse ndërkombëtare;
 - dispozitë për palët e prekura për procese lehtësisht të aksesueshme për rishikimin administrativ dhe juridik;
- të bindura se një instrument ndërkombëtar që përfshin objektivat e mësipërm dhe parimet që palët kontraktuese marrin përsipër të zbatojnë, do të çonte në nivel të lartë thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave dhe praktikave doganore, i cili është një qëllim thelbësor i këshillit të bashkëpunimit doganor, dhe në këtë mënyrë ofron një kontribut të madh për lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare, kanë rënë dakord si më poshtë.*

KAPITULLI I

Përkufizimet

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

- a) “Standard” do të thotë një dispozitë, zbatimi i së cilës pranohet si i nevojshëm për arritjen e harmonizimit dhe thjeshtimit të procedurave dhe praktikave doganore.
- b) “Standard i përkohshëm” do të thotë një standard në aneksin e përgjithshëm, për të cilin lejohet një periudhë më e gjatë zbatimi.
- c) “Praktikë e rekomanduar” do të thotë një dispozitë në një aneks të veçantë, i cili është njohur si progres i arritur drejt harmonizimit dhe thjeshtimit të procedurave dhe praktikave doganore, zbatimi sa më i gjerë i të cilit konsiderohet i përshtatshëm.
- d) “Legjislacion kombëtar” do të thotë ligjet, rregulloret dhe masa të tjera të vendosura nga autoriteti kompetent i një pale kontraktuese dhe që aplikohet nëpërmjet territorit të palës kontraktuese përkatëse apo traktatet në fuqi, pjesë e të cilave ajo palë është.
- e) “Aneks i përgjithshëm” do të thotë tërësia e dispozitave të zbatueshme për të gjitha procedurat dhe praktikat doganore të përmendura në këtë Konventë.
- f) “Aneks i veçantë” do të thotë tërësia e dispozitave të zbatueshme për një ose më shumë procedura dhe praktika doganore të përmendura në këtë Konventë.
- g) “Udhëzimet” do të thotë tërësia e shpjegimeve të dispozitave të aneksit të përgjithshëm, aneksit të veçantë dhe kapitujve të përfshirë këtu, të cilët tregojnë disa nga rrugët e mundshme të veprimit, për t’u ndjekur në zbatim të standardeve, standardeve të përkohshme dhe praktikave të rekomanduara, dhe në veçanti që përshkruajnë praktikat më të mira dhe rekomandojnë shembuj për lehtësira sa më të mëdha.
- h) “Komiteti i përhershëm teknik” do të thotë komiteti i përhershëm teknik i këshillit.
- i) “Këshill” do të thotë organizata e ngritur nga Konventa që krijon një këshill të bashkëpunimit doganor, bërë në Bruksel, më 15 dhjetor 1950.
- j) “Bashkim doganor ose ekonomik” do të thotë një bashkim i formuar nga, dhe i përbërë prej shteteve, i cili ka autoritetin të miratojë rregulloret e tij, që janë të detyrueshme për këto shtete, në lidhje me çështjet e trajtuara nga kjo Konventë, dhe ka autoritetin të vendosë, të nënshkruajë, të ratifikojë ose të miratojë këtë Konventë, në përputhje me procedurat e brendshme.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE STRUKTURA

Objekti i Konventës

Neni 2

Secila palë kontraktuese merr përsipër të nxisë thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave doganore dhe për këtë qëllim, të respektojë standardet në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, standardet e përkohshme dhe praktikatat e rekomanduara në anekset e kësaj Konvente. Megjithatë, asgjë nuk e pengon një palë kontraktuese nga ofrimi i lehtësirave më të mëdha se ato të parashikuara këtu, dhe secila palë kontraktuese rekomandohet të japë sa më shumë lehtësira të tilla që të jetë e mundur.

Neni 3

Dispozitat e kësaj Konvente nuk përjashtojnë zbatimin e legjislacionit kombëtar në lidhje me ndalimet ose kufizimet mbi mallrat që u nënshtrohen kontrollit doganor.

Struktura e Konventës

Neni 4

1. Konventa përfshin një pjesë kryesore, një aneks të përgjithshëm dhe anekset e veçanta.
2. Aneksi i përgjithshëm dhe secili aneks i veçantë i kësaj Konvente përbëhet, në parim, prej kapitujve, të cilët nëndajnë një aneks dhe përfshijnë:
 - a) përkufizimet; dhe
 - b) standardet, disa prej të cilave në aneksin e përgjithshëm janë standarde të përkohshme.
3. Secili aneks i veçantë, gjithashtu përbëhet nga praktikatat rekomanduese.
4. Çdo aneks është i shoqëruar nga udhëzime, tekstat e të cilave nuk janë të detyrueshme për palët kontraktuese.

Neni 5

Për qëllimet e kësaj Konvente, çdo aneks(e) i veçantë ose kapitull(j) që është i detyrueshëm për një palë kontraktuese konsiderohet pjesë përbërëse e Konventës, dhe për atë palë kontraktuese, çdo referencë në Konventë do të konsiderojë të përfshirë dhe referencën për këtë aneks(et) ose kapitullin(jt).

KAPITULLI III MENAXHIMI I KONVENTËS

Komiteti drejtues

Neni 6

1. Një komitet drejtues duhet të ngrihet për të marrë në konsideratë zbatimin e kësaj Konvente, çdo masë për të siguruar njëtrajtshmëri në interpretimin dhe zbatimin e saj, dhe çdo amendament të propozuar për të.
2. Palët kontraktuese duhet të jenë anëtarë të komitetit drejtues.
3. Administrata kompetente e çdo organi të kualifikuar për t'u bërë palë kontraktuese në këtë Konventë sipas dispozitave të nenit 8 ose të çdo anëtarit të organizatës botërore të tregtisë ka të drejtë të marrë pjesë si vëzhgues në seancat e komitetit drejtues. Statusi dhe të drejtat e këtyre vëzhguesve do të përcaktohen me vendim të këshillit. Të drejtat e mësipërme nuk mund të ushtrohen para hyrjes në fuqi të vendimit.
4. Komiteti drejtues mund të ftojë përfaqësues të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare për të marrë pjesë në seancat e komitetit drejtues si vëzhgues.
5. Komiteti drejtues:



- a) do t'i rekomandojë palëve kontraktuese:
 - i) amendime për pjesën kryesore të kësaj Konvente;
 - ii) amendime për aneksin e përgjithshëm, anekset e veçanta dhe kapitujt e mëposhtëm dhe përfshirjen e kapitujve të rinj për aneksin e përgjithshëm; dhe
 - iii) përfshirjen e anekseve të reja të veçanta dhe kapitujve të rinj në anekset e veçanta;
- b) mund të vendosë të amendojë praktikën e rekomanduara ose të përfshijë praktika të reja rekomanduese në anekset e veçanta ose në kapitujt e mëposhtëm në përputhje me nenin 16;
- c) do të shqyrtojë zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente në përputhje me nenin 13, paragrafi 4;
- d) do të rishikojë dhe përditësojë udhëzimet;
- e) do të shqyrtojë çdo çështje të lidhur me këtë Konventë që mund t'i jetë referuar;
- f) do të informojë komitetin e përhershëm teknik dhe këshillin për vendimet e tij.

6. Administrata kompetente e palëve kontraktuese do t'i komunikojë propozimet sekretarit të përgjithshëm të këshillit, sipas paragrafëve 5 (a), (b), (c) ose (d) të këtij neni, si dhe arsytet së bashku me çdo kërkesë për përfshirjen e çështjeve në agjendën e seancave të komitetit drejtues. Sekretari i përgjithshëm i këshillit do të sjellë propozimet në vëmendje të administratave kompetente të palëve kontraktuese dhe të vëzhguesve të përmendur në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

7. Komiteti drejtues do të mbledhet të paktën një herë në vit. Do të zgjedhë çdo vit një kryetar dhe nënkryetar. Sekretari i përgjithshëm i këshillit do të shpërndajë ftesën dhe projekttagjendën për administratat kompetente të palëve kontraktuese dhe për vëzhguesit e përmendur në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni të paktën gjashtë javë përpara se të mbledhet komiteti drejtues.

8. Kur një vendim nuk arrihet me marrëveshje, çështjet duhet të vendosen nga votimi i palëve kontraktuese të pranishme, përpara komitetit drejtues. Propozimet sipas paragrafëve 5(a), (b) ose (c) të këtij neni duhet të miratohen me shumicën e dy të tretave të votave. Të gjitha çështjet e tjera duhet të vendosen nga komiteti drejtues me shumicë votash.

9. Kur zbatohet neni 8, paragrafi 5 i kësaj konvente, bashkimet doganore ose ekonomike të cilat janë palët kontraktuese, në rast votimi, duhet të kenë vetëm një numër votash të barabartë me totalin e votave të caktuara për anëtarët e tyre, që janë palë kontraktuese.

10. Para mbylljes së sesionit të tij, Komiteti Drejtues do të miratojë një raport. Ky raport duhet t'i përcillet këshillit dhe palëve kontraktuese dhe vëzhguesve të përmendur në paragrafët 2, 3 dhe 4.

11. Rregullat e procedurave të këshillit do të zbatohen, në mungesë të dispozitave përkatëse në këtë nen, nëse komiteti drejtues nuk vendos ndryshe.

Neni 7

Për qëllim të votimit në komitetin drejtues, duhet të ketë një votim të veçantë për secilin aneks të veçantë dhe për secilin kapitull të një aneksi të veçantë.

a) Çdo palë kontraktuese ka të drejtë të votojë mbi çështje që lidhen me interpretimin, zbatimin ose amendimin e pjesës kryesore dhe aneksit të përgjithshëm të konventës.

b) Për sa u përket çështjeve në lidhje me një aneks të veçantë apo me një kapitull të një aneksi të veçantë që tashmë është në fuqi, vetëm ato palë kontraktuese që kanë pranuar atë aneks të veçantë ose kapitullin brenda tij, kanë të drejtë të votojnë.

c) Çdo palë kontraktuese gëzon të drejtën të votojë për draftet e anekseve të veçanta ose për kapitujt e rinj të një aneksi të veçantë.

KAPITULLI IV PALA KONTRAKTUESE

Ratifikimi i Konventës

Neni 8

1. Çdo anëtar i këshillit dhe çdo anëtar i Kombeve të Bashkuara ose agjencive të veçanta të saj mund të bëhet palë kontraktuese e kësaj Konvente:

a) duke e nënshkruar atë pa rezervë ratifikimi;

b) nga depozitimi i një instrumenti për ratifikim, i cili pas nënshkrimit i nënshtrohet ratifikimit; ose

c) duke aderuar në të.

2. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim deri më 30 qershor 1974, në zyrat qendrore të këshillit në Bruksel nga anëtarët e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni. Më pas do të jetë e hapur për aderim nga këta anëtarë.

3. Çdo palë kontraktuese, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit të kësaj Konvente, duhet të specifikojë se cilat prej anekseve të veçanta ose kapitujve në to ka pranuar, nëse ka pranuar ndonjë prej tyre. Më pas mund të njoftojë depozitarin, që pranon një ose më shumë anekse të veçanta ose kapituj në to.

4. Palët kontraktuese që pranojnë ndonjë aneks të ri të veçantë ose kapitull të ri të një aneksi të veçantë duhet të njoftojnë depozituesin në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni.

5. a) Çdo bashkim doganor ose ekonomik, në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, mund të bëhet një palë kontraktuese e kësaj Konvente. Një bashkim i tillë doganor ose ekonomik duhet të informojë depozitarin për kompetencat e tij në lidhje me çështjet e trajtuara nga kjo Konventë. Ky bashkim doganor ose ekonomik duhet të njoftojë gjithashtu depozitarin për çdo modifikim kryesor për aq sa i përket autoritetit të tij.

b) Një bashkim doganor apo ekonomik që është palë kontraktuese e kësaj Konvente, për çështje brenda kompetencave të tij, duhet të ushtrojë në emër të tij të drejtat dhe të përbushë përgjegjësitë, të cilat Konventa u jep anëtarëve të bashkimit, që janë palë kontraktuese të kësaj Konvente. Në këtë rast, anëtarët e një bashkimi të tillë nuk kanë të drejtë të ushtrojnë individualisht këto të drejta, përfshirë të drejtën për të votuar.

Neni 9

1. Çdo palë kontraktuese e cila ratifikon këtë Konventë ose aderon në të, duhet të përbushë detyrimet që i jep çdo amendim i kësaj Konvente, përfshirë aneksin e përgjithshëm, i cili ka hyrë në fuqi në datën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit.

2. Çdo palë kontraktuese e cila pranon një aneks të veçantë ose ndonjë kapitull brenda tij duhet të përbushë detyrimet që i jep çdo ndryshim i standardeve të përfshira në atë aneks të veçantë ose kapitull, që kanë hyrë në fuqi në datën kur depozitari njoftohet për pranimin e saj. Çdo palë kontraktuese e cila pranon një aneks të veçantë ose kapitull të tij, duhet të përbushë detyrimet që i jep çdo ndryshim në praktikën e rekomanduarë të përfshira aty, të cilat kanë hyrë në fuqi në datën kur depozitari njoftohet për pranimin e saj, përveç kur ka vërejtje ndaj një ose më shumë praktikave të rekomanduarë në përputhje me nenin 12 të kësaj Konvente.

Zbatimi i Konventës

Neni 10

1. Çdo palë kontraktuese, në kohën e nënshkrimit të kësaj Konvente pa vërejtje ndaj ratifikimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit të saj apo aderimit ose në çdo rast tjetër të mëvonshëm, mund të deklarojë nëpërmjet njoftimit që i është dhënë depozitarit, se kjo Konventë do të shtrihet në të



gjithë ose në ndonjë nga territoret për të cilat ai është përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky njoftim do të hyjë në fuqi tre muaj pas marrjes së tij nga depozitari. Megjithatë, kjo Konventë nuk do të zbatohet në territoret e përmendura në njoftim para se kjo Konventë të hyjë në fuqi për palën kontraktuese në fjalë.

2. Çdo palë kontraktuese që ka bërë një njoftim sipas paragrafit 1 të këtij neni duke e shtrirë këtë Konventë në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës, mund të njoftojë depozitarin sipas procedurave të nenit 19 të kësaj Konvente, se territori në fjalë nuk do të zbatohet më këtë Konventë.

Neni 11

Për zbatimin e kësaj Konvente, një bashkim doganor ose ekonomik që është një palë kontraktuese do të njoftojë sekretarin e përgjithshëm të këshillit të territoreve që formojnë bashkimin doganor ose ekonomik, dhe këto territore do të merren si një territor i vetëm.

Pranimi i dispozitave dhe rezervave

Neni 12

1. Me anë të kësaj Konvente, të gjitha palët kontraktuese janë të lidhura nga aneksi i përgjithshëm.

2. Një palë kontraktuese mund të pranojë një ose më shumë anekse të veçanta apo një ose më shumë kapituj aty. Një palë kontraktuese e cila pranon një aneks të veçantë apo një kapitull(j) aty, do të jetë e detyruar nga të gjitha standardet në të. Një palë kontraktuese e cila pranon një aneks të veçantë apo ndonjë kapitull(j) aty do të jetë e detyruar nga të gjitha praktikat e rekomanduara në të, vetëm nëse në kohën e pranimi ose në çdo kohë të mëvonshme, njofton depozitarin për praktikën(at) e rekomanduar(a) për të cilën ka vërejtje, duke shprehur ndryshimet që ekzistojnë midis dispozitave të legjislacionit të tij kombëtar dhe atyre të praktikës(ave) përkatëse të rekomanduar(a). Çdo palë kontraktuese e cila ka shprehur vërejtje mund t'i tërheqë ato, të gjitha ose pjesërisht në çdo kohë duke e njoftuar depozitarin dhe duke specifikuar datën në të cilën kjo tërheqje hyn në fuqi.

3. Secila palë kontraktuese, e detyruar nga një aneks i veçantë ose kapitull(j) aty, do të shqyrtojë mundësinë e tërheqjes së ndonjë rezerve për praktikat e rekomanduara të shprehura sipas kushteve të paragrafit 2 dhe do të njoftojë sekretarin e përgjithshëm të këshillit për rezultatet e këtij shqyrtimi në fund të çdo periudhe trevjeçare, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë palë kontraktuese, duke specifikuar dispozitat e legjislacionit të saj kombëtar që sipas mendimit të saj, janë në kundërshtim me tërheqjen e rezervave.

Zbatimi i dispozitave

Neni 13

1. Çdo palë kontraktuese duhet të zbatohet standardet e aneksit të përgjithshëm dhe të aneksit(eve) të veçantë(a) ose kapitullit(ve) aty, që ka pranuar brenda 36 muajve pasi ky aneks(e) ose kapitull(j) të kenë hyrë në fuqi për atë palë kontraktuese.

2. Çdo palë kontraktuese duhet të zbatohet standardet e përkohshme në aneksin e përgjithshëm brenda 60 muajve nga data kur aneksi i përgjithshëm ka hyrë në fuqi për atë palë kontraktuese.

3. Çdo palë kontraktuese duhet të zbatohet praktikat e rekomanduara në aneksin(et) e veçanta ose kapitullin(j) aty, që ajo ka pranuar brenda 36 muajve pasi ky aneks(e) ose kapitull(j) ka hyrë në fuqi për atë palë kontraktuese, përveçse kur janë bërë vërejtje për një ose më shumë praktika rekomanduese.

4. a) Kur periudhat e parashikuara në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, në praktikë, mund të jenë të pamjaftueshme, për ndonjë palë kontraktuese për të zbatuar dispozitat e aneksit të përgjithshëm, kjo palë kontraktuese mund t'i kërkojë komitetit drejtues, t'i japë një zgjatje të kësaj periudhe, përpara përfundimit të periudhës së përmendur në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni. Gjatë bërjes së kërkesës, pala kontraktuese duhet të shprehë dispozitën(at) e aneksit të përgjithshëm në lidhje me të cilën një zgjatje e kësaj periudhe është kërkuar dhe arsyet e një kërkesë të tillë.

b) Në kushte të jashtëzakonshme, komiteti drejtues mund të vendosë të miratojë një shtyrje të tillë. Çdo vendim nga komiteti drejtues që miraton një shtyrje të tillë duhet të shprehë kushtet e jashtëzakonshme duke justifikuar vendimin dhe shtyrja në asnjë rast nuk duhet të jetë më shumë se 1 vit. Me mbarimin e periudhës së shtyrë, pala kontraktuese duhet të njoftojë depozituesin për zbatimin e dispozitave për të cilat është dhënë shtyrja.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 14

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, për sa është e mundur duhet të zgjidhet me bisedime midis tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje që nuk zgjidhet me negociata do t'i referohet, nga palët kontraktuese në mosmarrëveshje, komitetit drejtues, i cili duhet të marrë parasysh mosmarrëveshjen dhe të bëjë rekomandime për zgjidhjen e saj.

3. Palët kontraktuese në konflikt mund të bien dakord paraprakisht për të pranuar rekomandimet e komitetit drejtues si të detyrueshme.

Amendamentet e Konventës

Neni 15

1. Teksti i çdo amendimi rekomanduar palëve kontraktuese nga komiteti drejtues në përputhje me nenin 6, paragrafi 5 (a) (i) dhe (ii) do t'u komunikohet të gjitha palëve kontraktuese dhe atyre anëtarëve të këshillit që nuk janë palë kontraktuese, nga sekretari i përgjithshëm i këshillit.

2. Amendimet në pjesën kryesore (në tekstin) e Konventës do të hyjnë në fuqi për të gjitha palët kontraktuese dymbëdhjetë muaj pas depozitimit të instrumenteve të pranimit nga këto palë kontraktuese të pranishme në seancën e komitetit drejtues, gjatë së cilës u rekomanduan amendimet, me kusht që asnjë kundërshtim të mos jetë depozituar nga ndonjë palë kontraktuese brenda një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh nga data e komunikimit të këtyre amendamenteve.

3. Çdo amendim i rekomanduar për aneksin e përgjithshëm ose për anekset e veçanta ose për kapitujt në të, do të konsiderohen si të pranuar gjashtë muaj pas datës kur amendimet e rekomanduara u janë komunikuar palëve kontraktuese, përveç kur:

a) ka pasur një kundërshtim nga një palë kontraktuese ose, në rastin e një aneksi të veçantë apo kapitulli, nga një palë kontraktuese me detyrime ndaj këtij aneksi të veçantë apo kapitulli; ose

b) një Palë kontraktuese njofton sekretarin e përgjithshëm të këshillit se, megjithëse do të pranojë ndryshimin e rekomanduar, kushtet e nevojshme për këtë pranim nuk janë përmbushur ende.

4. Nëse një palë kontraktuese i dërgon sekretarit të përgjithshëm të këshillit një komunikim, siç parashikohet në paragrafin 3 (b) të këtij neni, nëse nuk ka njoftuar sekretarin e përgjithshëm të këshillit për pranimin e amendamentit të rekomanduar, mund të paraqesë një kundërshtim për këtë amendament brenda një periudhe prej tetëmbëdhjetë muajsh pas përfundimit të periudhës gjashtëmuajore të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni.

5. Nëse një kundërshtim për amendamentin e rekomanduar njoftohet në përputhje me kushtet e paragrafit 3 (a) ose 4 të këtij neni, amendamenti do të konsiderohet i papranuar dhe nuk ka asnjë fuqi.

6. Nëse ndonjë palë kontraktuese ka dërguar një komunikim në përputhje me paragrafin 3 (b) të këtij neni, amendamenti do të konsiderohet të jetë pranuar më parë se dy datat e mëposhtme:

a) datës prej së cilës të gjitha palët kontraktuese, që kanë dërguar këto njoftime, kanë njoftuar sekretarin e përgjithshëm të këshillit se kanë pranuar ndryshimin e rekomanduar, me kusht që nëse të gjitha pranimet janë njoftuar përpara përfundimit të periudhës gjashtëmuajore të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, kjo datë do të merret si data e përfundimit të periudhës gjashtëmuajore në fjalë;

b) data e mbarimit të periudhës tetëmbëdhjetëmuajore të përmendur në paragrafin 4 të këtij neni.

7. Çdo amendament i aneksit të përgjithshëm ose anekseve të veçanta ose kapitujve aty, i konsideruar për t'u pranuar, do të hyjë në fuqi ose gjashtë muaj pas datës në të cilën ishte vendosur për



t'u pranuar ose nëse një periudhë tjetër është specifikuar në amendamentin e rekomanduar, në përfundim të asaj periudhe pas datës në të cilën amendamenti ishte vendosur për t'u pranuar.

8. Sekretari i përgjithshëm i këshillit duhet, sa më shpejt që të jetë e mundur, të njoftojë palët kontraktuese të kësaj Konvente për çdo kundërshtim ndaj amendamentit të rekomanduar, të bërë në përputhje me paragrafin 3 (a) dhe çdo komunikim të marrë në përputhje me paragrafin 3 (b) të këtij neni. Më pas, sekretari i përgjithshëm i këshillit duhet të informojë palët kontraktuese nëse pala ose palët kontraktuese që kanë dërguar këtë komunikim kanë kundërshtim ndaj amendamentit të rekomanduar ose nëse e pranojnë atë.

Neni 16

1. Pavarësisht procedurës së amendimit të përcaktuar në nenin 15 të kësaj Konvente, komiteti drejtues, në përputhje me nenin 6, mund të vendosë të ndryshojë çdo praktikë të rekomanduar ose të përfshijë praktika të reja të rekomanduara në ndonjë aneks të veçantë ose në kapitullin aty. Sekretari i përgjithshëm i këshillit duhet të ftojë secilën palë kontraktuese për të marrë pjesë në diskutimet e komitetit drejtues. Teksti i ndonjë amendamenti të tillë ose praktikave të reja të rekomanduara të rëna dakord duhet t'u komunikohet palëve kontraktuese dhe atyre anëtarëve të këshillit që nuk janë palë kontraktuese të kësaj Konvente, nga sekretari i përgjithshëm i këshillit.

2. Çdo amendament apo përfshirje e praktikave të reja të rekomanduara të rëna dakord sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të hyjnë në fuqi gjashtë muaj pas komunikimit të tyre nga sekretari i përgjithshëm i këshillit. Secila palë kontraktuese e detyruar nga një aneks i veçantë ose kapitull aty, që përbën lëndën e këtyre amendamenteve apo përfshirjes të praktikave të reja të rekomanduara do të konsiderohen sikur të kenë pranuar këto amendamente apo praktika të reja të rekomanduara, përveçse kur shpreh vërejtje sipas procedurës të nenit 12 të kësaj Konvente.

Kohëzgjatja e aderimit

Neni 17

1. Kjo Konventë ka një kohëzgjatje të pakufizuar por çdo palë kontraktuese mund ta shpallë të pavlefshëm atë në çdo kohë pas datës së hyrjes në fuqi, sipas nenit 18.

2. Shpallja e pavlefshme do të njoftohet me shkrim me një instrument të depozituar te depozitari.

3. Shpallja e pavlefshme do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas marrjes së instrumentit të shpalljes së pavlefshme nga depozitari.

4. Dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni do të zbatohen gjithashtu për sa u përket anekseve të veçanta dhe kapitujve aty, për të cilat çdo palë kontraktuese mund të tërheqë pranimin e saj në çdo kohë nga data kur ka hyrë në fuqi.

5. Çdo palë kontraktuese që tërheq pranimin që ajo i ka bërë aneksit të përgjithshëm do të konsiderohet sikur ka shpallur të pavlefshëm Konventën. Në këtë rast do të zbatohen gjithashtu dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3.

KAPITULLI V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Hyrja në fuqi e Konventës

Neni 18

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pasi pesë nga subjektet e përmendura në paragrafët 1 dhe 5 të nenit 8 kanë nënshkruar Konventën pa ndonjë rezervë ratifikimi ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose aderimit.

2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi për çdo palë kontraktuese tre muaj pasi është bërë palë kontraktuese në përputhje me dispozitat e nenit 8.

3. Çdo aneks i veçantë ose kapitull i kësaj konvente do të hyjë në fuqi tre muaj pasi pesë palë kontraktuese të kenë pranuar atë aneks të veçantë apo atë kapitull.

4. Pas hyrjes në fuqi të ndonjë aneksi të veçantë apo kapitulli aty në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, ai aneks i veçantë apo kapitull aty do të hyjë në fuqi për çdo palë kontraktuese tre muaj pasi kjo e fundit të ketë njoftuar pranimin e tyre. Megjithatë, asnjë aneks i veçantë apo kapitull aty nuk do të hyjë në fuqi për një palë kontraktuese para se kjo Konventë të ketë hyrë në fuqi për atë palë kontraktuese.

Depozitari i Konventës

Neni 19

1. Kjo Konventë, të gjitha firmat me ose pa rezervat e ratifikimit dhe të gjitha instrumentet e ratifikimit apo aderimit do të depozitohen te sekretari i përgjithshëm i këshillit.

2. Depozitari:

a) do të marrë dhe ruajë tekstet origjinale të kësaj Konvente;

b) do të përgatisë kopje të vërtetuara të teksteve origjinale të kësaj Konvente dhe do t'ua transmetojë ato palëve kontraktuese dhe atyre anëtarëve të këshillit që nuk janë palë kontraktuese dhe sekretarit të përgjithshëm të kombeve të bashkuara;

c) do të marrë çdo firmë me ose pa rezervat e ratifikimit, ratifikimin apo aderimin në këtë Konventë dhe do të marrë e ruajë çdo instrument, njoftime dhe komunikime në lidhje me to;

d) do të shqyrtojë nëse nënshkrimi i ndonjë instrumenti, njoftimi apo komunikimi në lidhje me këtë Konventë është në kohën dhe formën e duhur dhe nëse është e nevojshme, ta sjellë këtë çështje në vëmendje të palës kontraktuese në fjalë;

e) do të njoftojë palët kontraktuese, ata anëtarë të këshillit që nuk janë palë kontraktuese, dhe sekretarin e përgjithshëm të kombeve të bashkuara për:

- nënshkrimet, ratifikimet, aderimet dhe pranimet e anekseve dhe kapitujve sipas nenit 8 të kësaj Konvente;

- kapitujt e rinj të aneksit të përgjithshëm dhe për anekset e veçanta ose kapitujt aty, të cilat komiteti drejtues vendos t'i rekomandojë që të përfshihen në këtë Konventë;

- datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, të aneksit të përgjithshëm dhe të secilit aneks të veçantë apo kapitulli aty, në përputhje me nenin 18 të kësaj Konvente;

- njoftimet e marra në përputhje me nenet 8, 10, 11, 12 dhe 13 të kësaj Konvente;

- tërheqjet e pranimeve të anekseve/kapitujve nga palët kontraktuese;

- shpalljet e pavlefshme sipas nenit 17 të kësaj Konvente; dhe

- çdo amendamenti të pranuar në përputhje me nenin 15 të kësaj Konvente dhe për datën e hyrjes në fuqi.

3. Në rast të ndonjë konflikti që lind midis një pale kontraktuese dhe depozitarit në lidhje me kryerjen e funksioneve të këtij të fundit, depozitari ose ajo palë kontraktuese do ta sjellë çështjen në vëmendje të palëve të tjera kontraktuese dhe atyre që e kanë nënshkruar ose sipas rastit, në vëmendje të komitetit drejtues ose këshillit.

Regjistrimi dhe tekstet origjinale

Neni 20

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë do të regjistrohet te sekretariati i Kombeve të Bashkuara, me kërkesë të sekretarit të përgjithshëm të këshillit.

Në dëshmi të kësaj nënshkruesit, të autorizuar siç duhet, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Kyoto, më 18 maj 1973 në gjuhët angleze dhe franceze, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike, në një origjinal të vetëm që do të depozitohet te sekretari i përgjithshëm i këshillit, i cili do t'ua shpërndajë kopje të vërtetuara të gjitha subjekteve të përmendura në paragrafin 1 të nenit 8 të kësaj Konvente.



ANEKS I PËRGJITHSHËM

KAPITULLI 1

PARIME TË PËRGJITHSHME

1.1. Standard

Përkufizimet, standardet dhe standardet e përkohshme në këtë aneks do të zbatohen për procedurat dhe praktikat doganore të specifikuar në këtë aneks dhe në masën që janë të zbatueshme, për procedura dhe praktika në anekse specifike.

1.2. Standard

Kushtet për t'u përmbushur dhe formalitetet doganore për t'u përmbushur për procedurat dhe praktikat në këtë aneks dhe në anekset specifike duhet të specifikohen në legjisllacionin kombëtar dhe të jenë sa më të thjeshta të jetë e mundur.

1.3. Standard

Doganat duhet të ndërtojnë dhe të ruajnë marrëdhënie formale konsultative me tregtinë për të rritur bashkëpunimin dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen në përcaktimin e metodave më efektive të punës në përputhje me dispozitat kombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

KAPITULLI 2

PËRKUFIZIMET

Për qëllime të anekseve të kësaj Konvente:

- E1./ F23. “Apelim” nënkuptohet akti me anë të të cilit një person, që është ndikuar drejtpërdrejt nga një vendim ose mosveprim i doganave dhe e konsideron veten të dëmtuar nga kjo, kërkon korrigjim përpara një autoriteti kompetent.
- E2./ F19. “Vlerësim i detyrimeve dhe taksave” nënkupton përcaktimin e shumës së detyrimeve dhe taksave të pagueshme.
- E3./ F4. “Kontroll me bazë auditi” nënkupton masat me anë të të cilave doganat binden për saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve nëpërmjet shqyrtimit të librave përkatës, regjistrimeve, sistemeve të biznesit dhe të dhënat tregtare të mbajtura nga personat e interesuar.
- E4./ F15. “Verifikim i deklaramit të mallrave” nënkupton veprimin e marrë nga doganat për t'u bindur se deklarimi i mallrave është bërë në mënyrë të saktë dhe që dokumentet mbështetëse të kërkuara plotësojnë kushtet e paracaktuara.
- E5./ F9. “Zhdoganim” nënkupton plotësimin e formaliteteve doganore të nevojshme për të lejuar mallrat për të hyrë në përdorim në vend, për t'u eksportuar ose për t'u vendosur nën një procedurë tjetër doganore.
- E6./ F10. “Dogana” nënkupton shërbimin shtetëror i cili është përgjegjës për administrimin e ligjit doganor dhe mbledhjen e detyrimeve dhe taksave dhe e cila është gjithashtu përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të tjera mbi importimin, eksportimin, lëvizjen apo magazinimin e mallrave.
- E7./ F3. “Kontroll doganor” nënkupton masat e zbatuara nga doganat për të garantuar përputhjen me ligjin doganor.
- E8./ F11. “Detyrime doganore” nënkupton detyrimet e paracaktuara nga tarifa doganore për të cilat mallrat janë përgjegjëse për të hyrë apo për të lënë territorin doganor.
- E9./ F16. “Formalitetet doganore” nënkupton të gjitha operacionet të cilat duhet të kryhen nga personat e interesuar dhe nga doganat për t'u përputhur me ligjin doganor.
- E10./ F18. “Ligj doganor” nënkupton dispozitat e parashikuara me ligj dhe rregulloret në lidhje me importimin, eksportimin, lëvizjen apo magazinimin e mallrave, administrimi dhe ligjzbatimi i të cilave u ngarkohen veçanërisht doganave, si edhe çdo rregullore të bërë nga doganat nën kompetencat e tyre me ligj.
- E11./ “Zyrë doganore” nënkupton njësinë administrative doganore kompetente për përmbushjen e

- F2. formaliteteve doganore, si dhe ambientet apo zonat e tjera të miratuara për këtë qëllim nga autoritetet kompetente.
- E12./ "Territor doganor" nënkupton territorin në të cilin zbatohet ligji doganor i një pale
F25. kontraktuese.
- E13./ "Vendim" nënkupton aktin individual me anë të të cilit dogana vendos për një çështje në lidhje
F6. me ligjin doganor.
- E14./ "Deklarues" nënkupton çdo person që bën një deklaram mallrash ose në emër të të cilit bëhet
F7. një deklaram i tillë.
- E15./ "Datë e caktuar" nënkupton datën e caktuar për pagimin e detyrimeve dhe taksave të
F5. kërkueshme.
- E16./ "Detyrime dhe taksa" nënkupton detyrimet dhe taksat e importit dhe/ose detyrimet dhe taksat e
F12. eksportit.
- E17./ "Shqyrtimi i mallrave" nënkupton inspektimin fizik të mallrave nga doganat për t'u bindur se
F27. natyra, origjina, kushtet, sasia dhe vlera e mallrave janë në përputhje me hollësitat e dhëna në deklaramin e mallrave.
- E18./ "Detyrime dhe taksa eksporti" nënkupton detyrimet doganore dhe të gjitha detyrimet e tjera,
F13. taksat apo pagesat, të cilat mblidhen gjatë ose në lidhje me eksportimin e mallrave, por duke mos përfshirë detyrime të tjera të cilat kufizohen në shumë me shpenzimet e përafërta të shërbimeve të dhëna ose të mbledhura nga doganat në interes të një autoriteti tjetër kombëtar.
- E19./ "Deklarim i mallrave" nënkupton një deklaratë të bërë në mënyrën e paracaktuar nga Doganat,
F8. me anë të së cilës personat e interesuar i tregojnë doganave procedurën që zbatohet për mallrat dhe jep hollësitat që kërkohen nga doganat për zbatimin e saj.
- E20./ "Detyrime dhe taksa importi" nënkupton detyrimet doganore dhe të gjitha detyrimet e tjera,
F14. taksat apo pagesat, të cilat mblidhen gjatë ose në lidhje me importimin e mallrave, por duke mos përfshirë detyrime të tjera të cilat kufizohen në shumë me shpenzimet e përafërta të shërbimeve të dhëna ose të mbledhura nga doganat në interes të një autoriteti tjetër kombëtar.
- E21./ "Ndihmë e ndërsjellë administrative" nënkupton veprimet në interes të një administrate
F1. doganore ose veprimet në bashkëpunim me një administratë tjetër për zbatimin e duhur të ligjit doganor dhe për parandalimin, hetimin dhe shtypjen e krimeve doganore.
- E22./ "Mosveprim" nënkupton dështimin për të vepruar ose për të dhënë një vendim të kërkuar nga
F21. doganat sipas ligjit doganor brenda një afati kohor të arsyeshëm për një çështje të paraqitur siç duhet tek ato.
- E23./ "Person" nënkupton si personat fizikë edhe juridikë, përveç kur kërkohet ndryshe nga
F22. konteksti.
- E24./ "Çlirim i mallrave" nënkupton veprimin nga doganat për të lejuar mallrat që kalojnë
F20. zhdoganimin që të vendosen në dispozicion të personave të interesuar.
- E25./ "Shlyerje" nënkupton rimbursimin, të plotë ose pjesërisht të detyrimeve dhe taksave të paguara
F24. për mallrat dhe faljen, të plotë ose të pjesshme, të detyrimeve dhe taksave kur nuk është bërë pagesa.
- E26./ "Garanci" nënkupton atë e cila garanton doganat se detyrimi ndaj tyre është përmbushur.
F17. Garancia përshkruhet si "e përgjithshme" kur ajo garanton që do të përmbushen të gjitha detyrimet që lindin nga disa operacione.
- E27./ "Palë e tretë" nënkupton çdo person që merret drejtpërdrejt me doganat, për dhe në interes të
F26. një personi tjetër, në lidhje me importimin, eksportimin, lëvizjen dhe magazinimin e mallrave.



KAPITULLI 3 ZHDOGANIMI DHE FORMALITETET E TJERA DOGANORE

Zyrat doganore kompetente

3.1. Standard

Doganat caktojnë zyrat doganore tek të cilat mallrat mund të prodhohen ose zhdoganohen. Në përcaktimin e kompetencave dhe vendndodhjen e këtyre zyrave dhe orët e tyre të punës, faktorët që do të merren në konsideratë duhet të përfshijnë në veçanti kërkesat e tregtisë.

3.2. Standard

Me kërkesë të personit të interesuar dhe për arsye të konsideruara të vlefshme nga doganat, kjo e fundit, në varësi të burimeve në dispozicion, kryen funksionet e përcaktuara për qëllime të një procedure dhe praktike doganore jashtë orëve të punës ose larg zyrave doganore. Çdo shpenzim i ngarkuar nga doganat duhet të kufizohet me koston e përafërt të shërbimeve të dhëna.

3.3. Standard

Kur zyrat doganore janë në një pikë kalimi të përbashkët kufitar, administratat doganore në fjalë duhet të bashkërendojnë orët e punës dhe kompetencat e këtyre zyrave.

3.4. Standard i përkohshëm

Në pika kalimi të përbashkëta kufitare, administratat doganore në fjalë, kurdoherë që është e mundur, kryejnë kontrolle të përbashkëta.

3.5. Standard i përkohshëm

Kur doganat kanë si qëllim të caktojnë një zyrë të re doganore ose të kthejnë një zyrë ekzistuese në një pikë kalimi të përbashkët kufitar, ato, kurdoherë që është e mundur, duhet të bashkëpunojnë me doganat fqinje për të caktuar një zyrë doganore të përbashkët për të lehtësuar kontrollet e përbashkëta.

Deklaruesi

a) Personat që kanë të drejtë të veprojnë si deklarues

3.6. Standard

Legjislacioni kombëtar specifikon kushtet nën të cilat një person ka të drejtë të veprojë si deklarues.

3.7. Standard

Çdo person që ka të drejtën e disponimit të mallrave ka të drejtë të veprojë si një deklarues.

b) Përgjegjësitë e deklaruesit

3.8. Standard

Deklaruesi është përgjegjës para doganave për saktësinë e hollësirave të dhëna në deklarimin e mallrave dhe për pagimin e detyrimeve dhe taksave.

c) Të drejtat e deklaruesit

3.9. Standard

Përpara depozitimit të deklarimit të mallrave, deklaruesi lejohet, sipas kushteve të përcaktuara nga doganat:

a) të inspektojë mallrat; dhe

b) të marrë mostra.

3.10. Standard

Doganat nuk duhet të kërkojnë një deklarim mallrash të veçantë për sa u përket mostrave të marra nën mbikëqyrje doganore, me kusht që mostra të tilla të përfshihen në deklarimin e mallrave në lidhje me ngarkesën përkatëse.

Deklarimi i mallrave

a) Formati dhe përmbajtja e deklarimit të mallrave

3.11. Standard

Përmbajtja e deklarimit të mallrave duhet të paracaktohet nga doganat. Formati në letër i deklarimit të mallrave duhet të jetë në përputhje me modelin e OKB-së.

Për procese të automatizuara të zhdoganimeve doganore, formati elektronik i depozituar i deklarimit të mallrave duhet të mbështetet në standardet ndërkombëtare për shkëmbimin elektronik të informacionit, siç paracaktohet në rekomandimet e këshillit të bashkëpunimit doganor për teknologjinë e informacionit.

3.12. Standard

Doganat duhet të kufizojnë të dhënat e kërkuara në deklarimin e mallrave vetëm për ato hollësi që gjykohen të nevojshme për vlerësimin dhe mbledhjen e detyrimeve dhe taksave, përgatitjen e statistikave dhe zbatimin e ligjit doganor.

3.13. Standard

Kur, për arsye të gjykuara të vlefshme nga doganat, deklaruesi nuk ka të gjithë informacionin e kërkuar për të bërë deklarimin e mallrave, një deklarim mallrash i përkohshëm apo i paplotë lejohet të depozitohet, me kusht që të përmbajë detajet e nevojshme për doganat dhe që deklaruesi merr përsipër ta plotësojë brenda një periudhe kohore të specifikuar.

3.14. Standard

Nëse doganat regjistrojnë një deklarim mallrash të përkohshëm apo të paplotë, trajtimi tarifor që i akordohet mallrave nuk duhet të jetë ndryshe nga ai i cili do të akordohej sikur deklarimi i mallrave të depozitohet i plotë dhe i saktë që në momentin e parë.

Çlirimi i mallrave nuk duhet të vonohet kur është dhënë garancia e kërkuar për mbledhjen e detyrimeve dhe taksave të zbatueshme.

3.15. Standard

Doganat duhet të kërkojnë depozitimin e deklarimit fillestar të mallrave dhe vetëm numrin minimal të kopjeve të nevojshme.

b) Dokumentet që mbështesin deklarimin e mallrave

3.16. Standard

Në mbështetje të deklarimit të mallrave, doganat kërkojnë vetëm ato dokumente që janë të nevojshme për të lejuar kontrollin e operacionit dhe që garantojnë se të gjitha kërkesat në lidhje me zbatimin e ligjit doganor janë në përputhje me atë.

3.17. Standard

Kur dokumente të caktuara mbështetëse nuk mund të depozitohen me deklarimin e mallrave për arsye të gjykuara të vlefshme nga doganat, ato duhet të lejojnë përgatitjen e këtyre dokumenteve brenda një periudhe kohore të specifikuar.

3.18. Standard i përkohshëm

Doganat duhet të lejojnë depozitimin e dokumenteve mbështetëse me anë të mjeteve elektronike.

3.19. Standard

Doganat nuk duhet të kërkojnë përkthimin e hollësirave të dokumenteve mbështetëse, përveç kur është e nevojshme për të lejuar përpunimin e deklarimit të mallrave.

Depozitimi, regjistrimi dhe verifikimi i deklarimit të mallrave

3.20. Standard

Doganat duhet të lejojnë depozitimin e deklarimit të mallrave në çdo zyrë doganore të caktuar.

3.21. Standard i përkohshëm

Doganat duhet të lejojnë depozitimin e deklarimit të mallrave me anë të mjeteve elektronike.

3.22. Standard

Deklarimi i mallrave duhet të depozitohet gjatë orëve të caktuara nga doganat.

3.23. Standard

Kur legjislacioni kombëtar përcakton një afat kohor për depozitimin e deklarimit të mallrave, koha e lejuar duhet të jetë e mjaftueshme për t'i dhënë mundësinë deklaruesit të plotësojë deklarimin e mallrave dhe të sigurojë dokumentet mbështetëse të kërkuara.

3.24. Standard

Me kërkesë të deklaruesit dhe për arsye të gjykuara të vlefshme nga doganat, kjo e fundit shtyn afatin kohor të paracaktuar për depozitimin e deklarimit të mallrave.

3.25. Standard



Legjislacioni kombëtar duhet të marrë masat për depozitimin dhe regjistrimin apo verifikimin e deklarimit të mallrave dhe dokumenteve mbështetëse përpara mbërritjes së mallrave.

3.26. Standard

Kur doganat nuk mund të regjistrojnë deklarimin e mallrave, ato duhet t'i japin arsyet deklaruesit.

3.27. Standard

Doganat duhet të lejojnë deklaruesin të ndryshojë deklarimin e mallrave që është depozituar, me kusht që në momentin e marrjes së kërkesës, doganat të mos kenë filluar të verifikojnë deklarimin e mallrave ose të kenë shqyrtuar mallrat.

3.28. Standard i përkohshëm

Doganat duhet të lejojnë deklaruesin të ndryshojë deklarimin e mallrave, kur merret kërkesa pas fillimit të verifikimit të deklarimit të mallrave, në qoftë se arsyet e dhëna nga deklaruesi gjykohen të vlefshme nga doganat.

3.29. Standard i përkohshëm

Deklaruesi lejohet të tërheqë deklarimin e mallrave dhe të aplikojë për një procedurë tjetër doganore, me kusht që kërkesa të jetë bërë përpara çlirimit të mallrave dhe kur arsyet e dhëna gjykohen të vlefshme nga doganat.

3.30. Standard

Verifikimi i deklarimit të mallrave bëhet në të njëjtin moment ose sa më shpejt që të jetë e mundur pas regjistrimit të deklarimit të mallrave.

3.31. Standard

Për qëllim të verifikimit të deklarimit të mallrave, doganat duhet të marrin vetëm veprime të tilla që i gjykojnë thelbësore për të garantuar pajtueshmërinë me ligjin doganor.

Procedura të veçanta për persona të autorizuar

3.32. Standard i përkohshëm

Për persona të autorizuar që plotësojnë kriteret e specifikuar nga doganat, duke përfshirë dhe një regjistrim të duhur të përputhshmërisë me kërkesat doganore dhe një sistem të kënaqshëm për menaxhimin e regjistrimeve të tyre tregtare, doganat duhet të parashikojnë:

- Çlirimin e mallrave me informacionin minimal të nevojshëm për të identifikuar mallrat dhe për të lejuar plotësimin e mëvonshëm të deklarimit përfundimtar të mallrave;

- Zhdoganimin e mallrave në ambientet e deklaruesit ose në një vend tjetër të autorizuar nga Doganat;

dhe, përveç kësaj, në masën e mundshme, procedura të tjera të veçanta të tilla si:

- Lejimin e një deklarimi të vetëm mallrash për të gjitha importet ose eksportet në një periudhë kohore të caktuar, kur mallrat janë importuar ose eksportuar shpesh nga i njëjti person;

- Përdorimin e regjistrimeve tregtare të personit të autorizuar për të vetëvlerësuar detyrimet dhe taksat që janë përgjegjës dhe sipas rastit, për të garantuar pajtueshmërinë me kërkesat e tjera doganore;

- Lejimin e depozitimit të deklarimit të mallrave me anë të një hedhje në regjistrin e personit të autorizuar dhe duke e mbështetur më pas me një deklarim plotësues mallrash.

Shqyrtimi i mallrave

a) Koha e kërkuar për shqyrtimin e mallrave

3.33. Standard

Kur doganat vendosin që të shqyrtohen mallrat e deklaruara, ky shqyrtim duhet të kryhet sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të deklarimit të mallrave.

3.34. Standard

Kur bëhen shqyrtime të planifikuara, prioritet duhet t'u jepet kafshëve të gjalla dhe mallrave që prishen dhe për mallra të tjera që doganat e pranojnë se kërkohen me urgjencë.

3.35. Standard i përkohshëm

Kur mallrat duhet të inspektohen nga autoritete të tjera kompetente dhe doganat gjithashtu kanë

planifikuar shqyrtim, doganat duhet të sigurojnë që inspektimet të bashkërendohen dhe, në qoftë se është e mundur, të kryhen në të njëjtën kohë.

b) Prania e deklaruesit gjatë shqyrtimit të mallrave

3.36. Standard

Doganat duhet të shqyrtojnë kërkesat nga deklaruesi për të qenë të pranishëm gjatë shqyrtimit të mallrave. Kërkesa të tilla duhet të pranohen, përveçse kur ekzistojnë rrethana përjashtuese.

3.37. Standard

Në qoftë se doganat e gjykojnë të dobishme, ato i kërkojnë deklaruesit të jetë i pranishëm ose të përfaqësohet gjatë shqyrtimit të mallrave dhe t'u japë doganave çdo ndihmë të nevojshme për lehtësimin e shqyrtimit.

c) Marrja e mostrave nga doganat

3.38. Standard

Mostrat duhet të merren vetëm kur gjykohet e nevojshme nga doganat për të përcaktuar përshkrimin tarifor dhe/ose vlerën e mallrave të deklaruar apo për të garantuar zbatimin e dispozitave të tjera të legjislacionit kombëtar. Mostrat e marra duhet të jenë sa më të vogla të jetë e mundur.

Gabimet

3.39. Standard

Doganat nuk duhet të vendosin penalitete thelbësore për gabime kur ato janë të bindura që gabime të tilla janë të paqëllimshme dhe nuk kanë si synim mashtrim apo neglizhencë flagrante. Kur ato e konsiderojnë të nevojshme për të ndëshkuar përsëritjen e gabimeve të tilla, mund të vendoset një penaltitet, por të mos jetë më i madh se i nevojshëm për këtë qëllim.

Çlirimi i mallrave

3.40. Standard

Mallrat e deklaruar duhet të çlirohen sapo doganat t'i kenë shqyrtuar ato ose kanë vendosur për të mos i shqyrtuar, me kusht që:

- të mos jetë konstatuar asnjë shkelje;
- të jetë marrë licenca e importit ose e eksportit apo dokumentet e tjera të kërkuara;
- të jenë marrë të gjitha lejet në lidhje me procedurën në fjalë; dhe
- çdo detyrim apo taksa të jenë paguar ose të jenë marrë masat e duhura për të garantuar mbledhjen e tyre.

3.41. Standard

Në qoftë se doganat janë të bindura që deklaruesi do të plotësojë më pas të gjitha formalitetet për sa i përket zhdoganimit, ato duhet të çlirojnë mallrat, me kusht që deklaruesi të japë një dokument zyrtar apo tregtar me hollësitat kryesore të ngarkesës në fjalë dhe të jenë të pranueshme për doganat, dhe garanci, nëse kërkohet, që ai garanton pagesën e detyrimeve dhe të taksave të aplikueshme.

3.42. Standard

Kur doganat vendosin që kërkohet analizë laboratorike e mostrave, dokumente të detajuara teknike ose mendim ekspertësh, ato i çlirojnë mallrat përpara njohjes së rezultateve të shqyrtimeve të tilla, me kusht që të jepet një garanci e kërkuar dhe kur doganat janë të bindura që mallrat nuk janë objekt kufizimesh apo ndalimesh.

3.43. Standard

Kur zbulohet një shkelje, doganat nuk duhet të presin për plotësimin e masës administrative apo ligjore përpara çlirimit të mallrave, me kusht që mallrat të mos i nënshtrohen konfiskimit apo të nevojiten si provë në një fazë të mëvonshme dhe kur deklaruesi paguan detyrimet dhe taksat dhe jep garanci për mbledhjen e detyrimeve dhe taksave shtesë, si edhe të çdo penaltiteti që mund të vendoset.

Braktisja ose asgjësimi i mallrave

3.44. Standard

Kur mallrat nuk janë çliruar ende për përdorim ose kur nuk janë vendosur nën një procedurë



tjetër doganore, si edhe kur nuk është zbuluar ndonjë shkelje, personit në fjalë nuk i kërkohet të paguajë detyrime dhe taksa apo t'i jepet e drejta e rimbursimit:

- kur, me kërkesë të tij, mallra të tilla braktisen nën kontrollin doganor te rezervat e shtetit ose asgjësohen apo bëhen të pavlefshme për tregti, siç mund të vendosë dogana. Çdo shpenzim që lind i ngarkohet personit në fjalë;

- kur këto mallra asgjësohen apo humbin në mënyrë të pakthyeshme nga ndonjë aksident apo forcë madhore, me kusht që ky asgjësim apo humbje të përcaktohet siç duhet për të bindur doganat;

- në rast mungesash për shkak të natyrës së mallrave, kur mungesa të tilla përcaktohen siç duhet për të bindur doganat.

Çdo mbetje apo skrap që mbetet pas asgjësimit të mallrave do t'i nënshtrohet, në qoftë se do vendosen në përdorim apo eksportohen, detyrimeve dhe taksave që do të ishin të aplikueshme nëse ky skrap apo kjo mbetje do të importohej apo eksportohej në atë vend.

3.45. Standard i përkohshëm

Kur doganat shesin mallra të cilat nuk janë deklaruar brenda afatit kohor të lejuar apo nuk mund të çliroheshin megjithëse nuk ishte konstatuar ndonjë shkelje, të ardhurat nga shitja, pas zbritjes së detyrimeve dhe taksave dhe të të gjithë pagesave të tjera dhe shpenzimeve të shkaktuara, do t'u ngarkohen atyre personave që kanë të drejtën mbi ato mallra ose, kur kjo nuk është e mundur, të lihen në dispozicion të tyre për një periudhë kohore të specifikuar.

KAPITULLI 4 DETYRIMET DHE TAKSAT

A. VLERËSIMI, MBLEDHJA DHE PAGESA E DETYRIMEVE DHE TAKSAVE

4.1. Standard

Legjislacioni kombëtar përcakton rrethanat kur shkaktohet detyrimi për detyrimet dhe taksat.

4.2. Standard

Periudha kohore brenda të cilës vlerësohen detyrimet dhe taksat duhet të përcaktohet në legjislacionin kombëtar. Vlerësimi duhet të bëhet sa më shpejt që është e mundur pas depozitimit të deklarimit të mallrave ose kur detyrimi shkaktohet ndryshe.

4.3. Standard

Faktorët në të cilët mbështetet vlerësimi i detyrimeve dhe taksave dhe kushtet nën të cilat ato përcaktohen, specifikohen në legjislacionin kombëtar.

4.4. Standard

Normat e detyrimeve dhe taksave përcaktohen në botimet zyrtare.

4.5. Standard

Legjislacioni kombëtar duhet ta përcaktojë momentin kohor për t'u marrë në konsideratë për qëllim të përcaktimit të normave të detyrimeve dhe taksave.

4.6. Standard

Legjislacioni kombëtar specifikon metodat që mund të përdoren për të paguar detyrimet dhe taksat.

4.7. Standard

Legjislacioni kombëtar specifikon personin(at) përgjegjës për pagesën e detyrimeve dhe taksave.

4.8. Standard

Legjislacioni kombëtar përcakton datën dhe vendin e duhur ku duhet të bëhet pagesa.

4.9. Standard

Kur specifikohet në legjislacionin kombëtar që data e caktuar mund të jetë pas çlirimit të mallrave, kjo datë duhet të jetë të paktën dhjetë ditë pas çlirimit. Asnjë interes nuk duhet të vendoset për periudhën kohore midis datës së çlirimit dhe datës së caktuar.

4.10. Standard

Legjislacioni kombëtar specifikon periudhën kohore brenda së cilës doganat mund të marrin hapa ligjorë për të mbledhur detyrimet dhe taksat e papaguara në datën e caktuar.

4.11. Standard

Legjislacioni kombëtar përcakton normën e interesit mbi shumat e detyrimeve dhe taksave që nuk janë paguar në datën e caktuar dhe kushtet e zbatimit të këtyre interesave.

4.12. Standard

Kur detyrimet dhe taksat janë paguar, një faturë që shërben si provë e pagesës duhet t'i lëshohet pagesit, përveç kur ka prova të tjera që dëshmojnë pagesën.

4.13. Standard i përkohshëm

Legjislacioni kombëtar duhet të specifikojë një vlerë minimale dhe/ose një shumë minimale të detyrimeve dhe taksave nën të cilën ato nuk do të mblidhen.

4.14. Standard

Në qoftë se doganat konstatojnë që gabimet në deklarimin e mallrave ose në vlerësimin e detyrimeve dhe taksave do të shkaktojnë ose kanë shkakuar mbledhje ose marrje më të vogël të detyrimeve dhe taksave sesa ato ligjërisht të ngarkueshme, doganat duhet të korrigjojnë gabimet dhe të mbledhin shumën e papaguar, megjithatë, nëse shuma e përfshirë është më pak se shuma minimale e specifikuar në legjislacionin kombëtar, doganat nuk duhet ta mbledhin ose ta marrin atë shumë.

B. SHTYRJA E PAGESAVE TË DETYRIMEVE DHE TAKSAVE

4.15. Standard

Kur legjislacioni kombëtar parashikon shtyrjen e pagesave të detyrimeve dhe taksave, ai duhet të specifikojë kushtet nën të cilat lejohet kjo lehtësi.

4.16. Standard

Shtyrja e pagesës duhet të lejohet pa interesa në masën e mundshme.

4.17. Standard

Periudha kohore për shtyrjen e pagesës së detyrimeve dhe taksave duhet të jetë të paktën 14 ditë.

C. SHLYERJA E DETYRIMEVE DHE TAKSAVE

4.18. Standard

Shlyerja e detyrimeve dhe taksave duhet të miratohet kur përcaktohet që detyrimet dhe taksat janë mbingarkuar si rezultat i ndonjë gabimi në vlerësimin e tyre.

4.19. Standard

Shlyerja e detyrimeve dhe taksave duhet të miratohet për sa u përket mallrave të importuara ose të eksportuara të cilat janë konstatuar të dëmtuara ose ndryshe në mospërputhje me specifikimet e rëna dakord në momentin e importimit ose eksportimit dhe janë rikthyer ose te furnizuesi ose te një person tjetër i caktuar nga ai, të cilat u nënshtrohen kushteve të mëposhtme:

- Mallrat nuk janë punuar, riparuar ose përdorur në vendin e importimit, dhe janë riekportuar brenda një afati kohor të arsyeshëm;

- Mallrat nuk janë punuar, riparuar ose përdorur në vendin në të cilin ato ishin eksportuar, dhe janë riimportuar brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Megjithatë, përdorimi i mallrave nuk duhet të pengojë shlyerjen e detyrimeve dhe taksave në qoftë se një përdorim i tillë ishte i domosdoshëm për të zbuluar defektet ose rrethana të tjera që shkaktojnë riekportimin ose riimportimin e mallrave.

Si alternativë ndaj riekportimit ose riimportimit, mallrat mund të braktisen te rezervat e shtetit ose të asgjësohen apo të bëhen të pavlefshme nga pikëpamja tregtare nën kontrollin doganor, siç mund të vendosin doganat. Kjo braktisje ose ky asgjësim nuk duhet t'i shkaktojë shpenzime rezervave të shtetit.

4.20. Standard i përkohshëm

Kur jepet leja nga doganat për mallra fillimisht të deklaruara për një procedurë doganore me pagesë detyrimesh dhe taksash që të vendosen nën një procedurë tjetër doganore, duhet të shlyhet çdo detyrim dhe taksë që ishte ngarkuar më shumë sesa shuma e duhur nën procedurën e re.

4.21. Standard

Vendimet për pretendimet për shlyerje detyrimesh dhe taksash duhet të arrihen dhe t'i njoftohen me shkrim personit të interesuar pa vonesë të paarsyeshme, dhe shlyerja e detyrimeve dhe taksave duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur pas verifikimit të pretendimeve.

4.22. Standard



Kur përcaktohet nga doganat që mbingarkimi është si rezultat i gabimit nga ana e doganave në vlerësimin e detyrimeve dhe taksave, shlyerja e tyre duhet të bëhet si një çështje me prioritet.

4.23. Standard

Kur vendosen afate kohore nën të cilat nuk pranohen pretendime për shlyerje detyrimesh dhe taksash, këto kufizime duhet të kenë një kohëzgjatje të mjaftueshme për të marrë në konsideratë çdo rrethanë të ndryshme që lidhet me çdo lloj rasti, në të cilin mund të miratohet shlyerje detyrimesh dhe taksash.

4.24. Standard

Shlyerja e detyrimeve dhe taksave nuk miratohet nëse shuma e përfshirë është më e vogël se shuma minimale e specifikuar në legjislacionin kombëtar.

KAPITULLI 5 GARANCIA

5.1. Standard

Legjislacioni kombëtar duhet të rendisë rastet në të cilat kërkohet garanci dhe të specifikojë format si të jepet garancia.

5.2. Standard

Doganat përcaktojnë shumën e garancisë.

5.3. Standard

Çdo personi që i kërkohet të japë garanci duhet t'i lejohej të zgjedhë një nga format e garancisë, me kusht që kjo të jetë e pranueshme për doganat.

5.4. Standard

Kur parashikohet në legjislacion, doganat nuk kërkojnë garanci kur ato janë të bindura që do të përmbushet detyrimi ndaj tyre.

5.5. Standard

Kur kërkohet garanci për të garantuar që të përmbushen detyrimet që rrjedhin nga procedura doganore, doganat duhet të pranojnë një garanci të përgjithshme, në veçanti nga deklaruesi i cili deklaron rregullisht mallra në zyra të ndryshme në territorin doganor.

5.6. Standard

Kur kërkohet garanci, shuma e garancisë që do jepet duhet të jetë sa më e ulët të jetë e mundur dhe, për sa i përket pagesës së detyrimeve dhe taksave, nuk duhet të kalojë shumën e mundshme që do i ngarkohet.

5.7. Standard

Kur jepet garanci, ajo duhet të shkarkohet sa më shpejt që të jetë e mundur pas bindjes së doganave që detyrimet nën të cilat është kërkuar garancia janë plotësuar siç duhet.

KAPITULLI 6 KONTROLLI DOGANOR

6.1. Standard

Të gjitha mallrat, përfshirë mjetet e transportit, të cilat hyjnë apo dalin nga territori doganor, pavarësisht se u nënshtrohen apo jo detyrimeve dhe taksave, janë objekt i kontrolleve doganore.

6.2. Standard

Kontrolli doganor duhet të kryhet në përputhje me ligjin doganor.

6.3. Standard

Për kryerjen e kontrollit doganor, doganat duhet të përdorin menaxhimin e riskut.

6.4. Standard

Doganat duhet të përdorin analizën e riskut për të përcaktuar personat, mallrat dhe mjetet e transportit që duhet të kontrollohen dhe shkallën e kontrollit të tyre.

6.5. Standard
Doganat duhet të miratojnë një strategji masash përputhshmërie në mbështetje të menaxhimit të riskut.

6.6. Standard

Sistemet e kontrolleve doganore duhet të përfshijnë kontrollet e bazuara te auditi.

6.7. Standard

Doganat do të kërkojnë bashkëpunim me administratat e tjera doganore dhe do të kërkojnë të lidhin marrëveshjet e ndihmës administrative për të rritur kontrollin doganor.

6.8. Standard

Doganat do të kërkojnë të bashkëpunojnë me tregtarët dhe të firmosin memorandume mirëkuptimi me ta, me qëllim rritjen e kontrollit doganor.

6.9. Standard i përkohshëm

Doganat do të përdorin teknologjinë e informacionit dhe mjetet elektronike në masën më të madhe të mundshme, me qëllim rritjen e kontrollit doganor.

6.10. Standard

Doganat duhet të vlerësojnë sistemet tregtare të subjekteve që kanë ndikim në operacionet doganore për t'u siguruar që këto sisteme plotësojnë kërkesat e doganave.

KAPITULLI 7 PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

7.1. Standard

Doganat duhet të përdorin teknologjinë e informacionit në mbështetje të operacioneve doganore kur kjo është me kosto efektive dhe efikase për doganat dhe për tregtarët. Doganat do të përcaktojnë kushtet për përdorimin e saj.

7.2. Standard

Për futjen e sistemeve kompjuterike, doganat do të përdorin standardet përkatëse të pranuar ndërkombëtarisht.

7.3. Standard

Futja e teknologjisë së informacionit do të bëhet duke u konsultuar sa më gjerësisht që të jetë e mundur me palët përkatëse që ndikohen drejtpërsëdrejti.

7.4. Standard

Legjislacioni kombëtar i ri ose i rishikuar do të përcaktojë:

- Kërkesat për përdorimin e metodave elektronike të punës si alternativë ndaj dokumenteve në letër;

- Metodave elektronike si edhe ato të dokumenteve në letër për autenticitetin;

- Të drejtën e doganës për të mbajtur informacion për nevojat e saj dhe, kur është e mundur, këtë informacion ta shkëmbejnë elektronikisht me administrata të tjera doganore dhe çdo palë tjetër të miratuar me ligj.

KAPITULLI 8 MARRËDHËNIA MIDIS DOGANAVE DHE PALËVE TË TRETË

8.1. Standard

Personat e interesuar do të kenë mundësi të zgjedhin nëse do t'i kryejnë vetë veprimet në lidhje me doganat apo do të caktojnë një palë të tretë që të veprojnë në emër të këtyre personave.

8.2. Standard

Legjislacioni kombëtar do të përcaktojë kushtet nën të cilat një person mund të veprojë në interes ose në emër të një personi tjetër në lidhje me doganat dhe do të përcaktojë gjithashtu përgjegjësitë e palëve të treta ndaj doganave për detyrimet dhe taksat, si edhe për çdo parregullsi.

8.3. Standard



Personat që zgjedhin të kryejnë vetë veprimet doganore nuk do të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme apo t'u nënshtrohen kërkesave më të rrepta krahasuar me ata që zgjedhin t'i kryejnë veprimet doganore nëpërmjet një pale të tretë.

8.4. Standard

Një person i caktuar si palë e tretë do të ketë të njëjta të drejta me personin që e ka caktuar atë për çështjet në lidhje me veprimet doganore.

8.5. Standard

Doganat do t'u mundësojnë palëve të treta pjesëmarrjen në konsultimet formale që doganat bëjnë me tregtarët.

8.6. Standard

Doganat do të përcaktojnë rrethanat nën të cilat ato nuk mund të kryejnë veprime me një palë të tretë.

8.7. Standard

Doganat duhet të njoftojnë me shkrim palën e tretë në lidhje me vendimin e tyre për moskryerjen e veprimeve.

KAPITULLI 9

INFORMACIONI, VENDIMET DHE AKTVENDIMET E DHËNA NGA DOGANAT

A. INFORMACION I ZBATIMIT TË PËRGJITHSHËM

9.1. Standard

Doganat sigurojnë që i gjithë informacioni përkatës për zbatim të përgjithshëm në lidhje me ligjin doganor është në dispozicion të çdo pale të interesuar.

9.2. Standard

Kur informacioni i vënë në dispozicion duhet të ndryshohet për shkak të ndryshimeve të ligjit doganor, rregullimeve ose kërkesave administrative, doganat duhet të vënë në dispozicion informacionin e ndryshuar për një kohë të mjaftueshme përpara se këto ndryshime të hyjnë në fuqi, me qëllim që t'u mundësojnë personave të interesuar t'i marrin parasysh ato, përveç kur njoftimi paraprak përjashtohet.

9.3. Standard i përkohshëm

Doganat do të përdorin teknologjinë e informacionit për të rritur dhënien e informacionit.

B. INFORMACION I NJË NATYRE SPECIFIKE

9.4. Standard

Me kërkesë të personit të interesuar, doganat do të sigurojnë, sa më shpejt dhe sa më saktë që të jetë e mundur, informacionin e kërkuar nga personi i interesuar për çështje specifike në lidhje me ligjin e doganave.

9.5. Standard

Doganat do të japin jo vetëm informacionin e kërkuar specifikisht por edhe çdo informacion tjetër që ka lidhje dhe për të cilin ata mendojnë se personi i interesuar duhet të vihet në dijeni.

9.6. Standard

Kur doganat japin informacion, ato duhet të sigurohen se nuk po zbulojnë të dhëna të një natyre private apo konfidenciale që ka ndikim te doganat ose palët e treta, përveç rasteve kur kjo kërkohet ose autorizohet nga legjislati kombëtar.

9.7. Standard

Kur doganat nuk mund të japin informacionin falas, çdo pagesë do të kufizohet me koston e përafërt të shërbimit të ofruar.

C. VENDIMET DHE AKTVENDIMET

9.8. Standard

Pas kërkesës me shkrim nga personi i interesuar, doganat duhet të njoftojnë vendimin e tyre me shkrim brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga legjislati kombëtar. Kur vendimi është kundër personit në fjalë, duhet të jepen arsyet e vendimit dhe të këshillohet e drejta e depozitimit të ankimit.

9.9. Standard

Doganat nxjerrin vendime detyruese me kërkesë të personit të interesuar, me kusht që ato të kenë në dispozicion të gjithë informacionin që e gjykojnë të nevojshëm.

KAPITULLI 10 APELIMET PËR ÇËSHTJE DOGANORE

A. E DREJTA E APELIMIT

10.1. Standard

Legjislacioni kombëtar parashikon të drejtën e apelimit për çështjet doganore.

10.2. Standard

Çdo person që preket drejtpërdrejt nga një vendim ose gabim i doganave ka të drejtën e apelimit.

10.3. Standard

Personit të prekur drejtpërdrejt nga një vendim ose gabim i doganave i jepet, pas kërkesës së tij me shkrim, arsyeja për një vendim ose gabim të tillë brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga legjislacioni kombëtar. Kjo mund të çojë ose jo në apelim.

10.4. Standard

Legjislacioni kombëtar duhet të parashikojë të drejtën e një apelimi fillestar ndaj doganave.

10.5. Standard

Kur një apelim ndaj doganave hidhet poshtë, apeluesi duhet të ketë të drejtën e një apelimi tjetër pranë një autoriteti që nuk është në varësi të administratës doganore.

10.6. Standard

Në instancën e fundit, apeluesi do të ketë të drejtën e apelimit në gjykatë.

B. FORMA DHE ARSYET E APELIMIT

10.7. Standard

Apelimi depozitohet me shkrim dhe duhet të përcaktojë arsyet mbi të cilat po bëhet.

10.8. Standard

Duhet të caktohet një afat kohor për depozitimin e një apelimi kundrejt një vendimi të doganave dhe ai duhet të jetë i tillë që t'i japë apeluesit kohë të mjaftueshme të studiojë vendimin e kundërshtuar dhe të përgatisë një apel.

10.9. Standard

Kur apelimi është ndaj doganave, ato nuk duhet të kërkojnë që prova mbështetëse të depozitohen bashkë me apelimin por në rrethanat e duhura, do të lejojnë një afat kohor të arsyeshëm për depozitimin e këtyre provave.

C. SHQYRTIMI I NJË APELI

10.10. Standard

Doganat do të japin vendimin mbi apelimin dhe do të njoftojnë me shkrim apeluesin sa më shpejt të jetë e mundur.

10.11. Standard

Kur një apelim ndaj doganave rrëzohet, doganat duhet të japin për këtë arsye me shkrim dhe do të këshillojnë apeluesin mbi të drejtën e tij për apelimin të mëtejshëm me një autoritet administrativ ose të pavarur dhe për afatet kohore të depozitimit të apelimit.

10.12. Standard

Kur apeli pranohet, doganat do të zbatojnë vendimin e tyre ose të një autoriteti gjyqësor ose të pavarur sa më shpejt të jetë e mundur, përveç kur doganat apelojnë ndaj vendimit.



LIGJ
Nr. 38/2012

PËR SHOQËRITË E BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, kritereve dhe kushteve për themelimin e administrimin e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve e të anëtarëve të tyre, riorganizimin dhe prishjen e tyre, si dhe rregullimin e vendosjen e kritereve për disa aspekte të veprimtarisë së tyre.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, të cilat themelohen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.

2. Përveç rasteve të parashikuara shprehimisht, për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor zbatohen edhe dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, titujt II, III dhe IV, për aq sa ato janë të zbatueshme dhe në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 3
Shoqëria e bashkëpunimit bujqësor

1. Shoqëria e bashkëpunimit bujqësor është një organizim vullnetar ndërmjet personave fizikë ose juridikë, me qëllim përmbushjen e nevojave apo interesave të tyre në fushën e prodhimit, të përpunimit dhe të tregtimit të produkteve bujqësore e blegtorale, kryesisht por pa u kufizuar, nëpërmjet marrëveshjeve apo bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet tyre dhe shoqërisë për shërbime, mallra apo produkte të sektorit bujqësor ose blegtoral, si dhe nëpërmjet promovimit të veprimtarive të tyre ekonomike.

2. Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, të cilat krijohen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, janë subjekt i lehtësive fiskale dhe skemave mbështetëse, sipas legjislacionit në fuqi.

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit 1435/2003/KE, datë 22 korrik 2001 “Mbi statutin e shoqërive europiane të kooperativave”. Numri CELEX 32003R0095, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 207, datë 18.8.2003, faqe 1-24.

KREU II VEPRIMTARIA E SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR

Neni 4

Objekti i veprimtarisë dhe tipat e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor

Shoqëritë, në bazë të objektit të veprimtarisë që ushtrojnë, ndahen në disa tipa si më poshtë:

a) Shoqëri të bashkëpunimit në fushën e prodhimit bujqësor dhe në marketing. Këto shoqëri mund të prodhojnë, të manipulojnë, të përpunojnë, të ruajnë, të klasifikojnë, të transportojnë, të shpërndajnë, si dhe të tregtojnë produktet bujqësore ose blegtorale në gjendjen e tyre natyrale ose të përpunuar më parë.

b) Shoqëri të bashkëpunimit në veprimtarinë e punës bujqësore. Këto shoqëri mund të kryejnë veprimtari të punës bujqësore për anëtarët ose të tretët, duke përfshirë dhe anëtarët punëtorë.

c) Shoqëri të bashkëpunimit për konsumin e lëndëve dhe mallrave. Këto shoqëri mund të kryejnë veprimtari të furnizimit me mallra dhe shërbime të blera nga anëtarët, të tretët ose të prodhuara nga vetë shoqëria, për përdorim dhe konsum të anëtarëve ose të tretëve.

ç) Shoqëri të bashkëpunimit për inputet. Këto shoqëri mund të blejnë, të përpunojnë, të prodhojnë dhe të fabrikojnë me çfarëdo lloj procesi ushqime për bagëtinë, plehra kimike, bimë, farëra, produkte fitosanitare, materiale, instrumente, makineri, impiante, produkte me prejardhje nga kafshët dhe çfarëdo lloj produktesh të tjera, të nevojshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e prodhimit, bujqësor dhe blegtoral.

d) Shoqëri të bashkëpunimit për qëllime të tjera në fushën e bujqësisë. Këto shoqëri mund të ushtrojnë çdo lloj veprimtarie tjetër të nevojshëm që favorizon dhe lehtëson përmirësimin ekonomik, teknik, ekologjik dhe të kushteve të punës të çfarëdo lloj fermeri apo operatori ekonomik, i cili operon në fushën e bujqësisë dhe të blegtorisë.

Neni 5

Përgjegjësia e kufizuar

1. Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj me të gjithë pasurinë aktuale dhe të ardhshme.
2. Anëtarët e shoqërisë janë përgjegjës për detyrimet e shoqërisë deri në vlerën e kontributeve të nënshkruara të kapitalit të shoqërisë, qofshin ose jo të shlyera.

Neni 6

Selia dhe emërtimi

1. Selia e shoqërisë përcaktohet në statut, kryesisht, në zonën ku kjo shoqëri kryen veprimtarinë ose ku ka të përqendruar veprimtarinë drejtuese.

2. Shoqëria ka emërtimin e saj, i cili përcaktohet në statut dhe që duhet të përmbajë fjalët “Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor”.

3. Në të gjitha shkresat, publikimet dhe dokumentet e shoqërisë, emërtimi i saj duhet të paraprihet nga fjalët “Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor”, pas të cilave shënohen emërtimi i shoqërisë dhe numri i regjistrimit të saj. Në asnjë rast një shoqëri tjetër nuk mund të përdorë të njëjtën emërtim.

Neni 7

Veprime me të tretët

Statuti mund të parashikojë që shoqëria të kryejë veprimtari dhe shërbime në kuadër të objektit të përcaktuar në statut, përveç se me anëtarët e saj edhe me persona fizikë ose juridikë, të tretët, jo anëtarë, deri në 40 për qind të totalit të të ardhurave nga veprimtaritë e saj, gjithmonë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.



KREU III
THEMELIMI, NUMRI I ANËTARËVE DHE STATUTI I SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT
BUJQËSOR

Neni 8

Akti i themelimit

Akti i themelimit të shoqërisë nënshkruhet nga të gjithë nismëtarët dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) identitetin e themeluesve dhe të administratorit apo administratorëve;
- b) deklaratën e përmbushjes së kriterëve për të qenë anëtar;
- c) emërtimin e shoqërisë;
- ç) objektin e shoqërisë;
- d) selinë;
- dh) kapitalin e shoqërisë;
- e) përqindjen e kapitalit të zotëruar nga secili anëtar.

Neni 9

Personaliteti juridik

1. Pas themelimit të saj, shoqëria regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
2. Me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, shoqëria fiton personalitet juridik.

Neni 10

Numri i anëtarëve të shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor

Për krijimin e shoqërisë, numri minimal i anëtarëve të nevojshëm duhet të jetë 7. Ky numër mund të zmadhohet ose të zvogëlohet pa asnjë kufizim përgjatë veprimtarisë së shoqërisë, por nuk duhet të jetë nën kufirin minimal të anëtarëve të përcaktuar në këtë nen.

Neni 11

Statuti

1. Statuti i shoqërisë përmban këto të dhëna:
 - a) emërtimin;
 - b) objektin e veprimtarisë;
 - c) selinë dhe adresën e saj;
 - ç) afatin e veprimtarisë, nëse parashikohet që shoqëria të ngrihet me afat të kufizuar;
 - d) vlerën e kapitalit të nënshkruar;
 - dh) vlerën minimale të detyrueshme për derdhje në kapital si kontribut, si dhe formën e afatet për të fituar statusin e anëtarit;
 - e) numrin e pjesëve, në të cilat ndahet kapitali, dhe vlerën e secilës pjesë sipas kontributit të anëtarëve;
 - ë) të dhënat për anëtarët themelues;
 - f) kriteret për pranimin e anëtarëve, kushtet e afatet për largimin vullnetar dhe përjashtimin e anëtarëve;
 - g) të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve;
 - gj) organet e shoqërisë, kompetencat e tyre, mënyrën e funksionimit dhe të vendimmarrjes;
 - h) identitetin e administratorit ose të administratorëve në çastin e përpilimit të statutit, si dhe afatet, largimin e përgjegjësitë e administratorit gjatë përmbushjes së funksioneve;

- i) të drejtën për rimbursim të kontributeve të anëtarëve që largohen;
 - j) të dhënat e ekspertit/ëve kontabël të shoqërisë.
2. Çdo ndryshim në të dhënat e statutit, të përcaktuara më lart, regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU IV ANËTARËT E SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR

Neni 12

Anëtarët e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor

Anëtarë të shoqërisë janë personat fizikë ose juridikë, të cilët përmbushin nevojat dhe interesat e tyre, lidhur me veprimtarinë bujqësore dhe blegtorale që ushtrojnë, nëpërmjet shërbimeve, mallrave apo produkteve të ofruara nga shoqëria.

Neni 13

Pranimi i anëtarëve të rinj

1. Kërkesa për pranimin e anëtarit të ri bëhet me shkrim dhe i drejtohet administratorit, i cili ia kalon kërkesën asamblesë së përgjithshme në mbledhjen e saj më të parë, sipas procedurës së përcaktuar në statut.
2. Pranimi i anëtarit të ri shoqërohet me nënshkrimin e kontributit dhe derdhjen e kontributit të detyrueshëm në kapitalin shoqëror, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të statutit.
3. Statuti mund të parashikojë kritere për pranimin e anëtarëve të rinj, të cilat lidhen me objektin e shoqërisë.
4. Shoqëria mban në selinë e saj një regjistër të anëtarëve, i cili është publik dhe i konsultueshëm dhe që përmban të gjitha të dhënat e tyre identifikuese, adresat, si dhe kapitalin e nënshkruar e të shlyer prej tyre.
5. Çdo anëtar i ri dhe çdo veprim, i cili ndryshon kapitalin e nënshkruar apo mënyrën e ndarjes së tij, si rrjedhojë e pranimin të anëtarit të ri, duhet të shënohen në regjistrin e anëtarëve, që mbahet nga shoqëria, si dhe të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 14

Të drejtat e anëtarëve

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve përcaktohen në këtë ligj dhe në statutin e shoqërisë.
2. Sipas këtij ligji, anëtarët kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:
 - a) të propozojnë ndryshimin e administratorëve të shoqërisë.
 - b) të propozojnë ndryshime apo përmirësime të statutit.
 - c) të kërkojnë dhe të disponojnë kopje të statutit, të rregullores së brendshme apo të vendimeve të organeve drejtuese të shoqërisë, kryesisht, kur preken interesat e tyre.
 - ç) të kërkojnë dhe të marrin të dhëna për gjendjen financiare dhe ekonomike të tyre brenda shoqërisë.
 - d) të informohen, sa herë që depozitojnë kërkesë më shkrim, lidhur me gjendjen financiare të shoqërisë, kryesisht, për:
 - i) llogaritë vjetore financiare;
 - ii) raportin e veprimtarisë së shoqërisë;
 - iii) mënyrën dhe procedurat e ndarjes së fitimit;
 - iv) raportet e ekspertëve kontabël;
 - dh) të informohen rregullisht për mbledhjet e asamblesë së përgjithshme, duke përfshirë në informacion pikat e rendit të ditës, dokumentacionin e përgatitur për mbledhje, si dhe të dhëna të tjera, të cilat lidhen me vendimmarrjen për çështje të caktuara, të cilat mund të prekin interesat e tyre.



3. Nëse në statut nuk parashikohet ndryshe, administratori informon me shkrim anëtarin për çështjet e trajtuara në kërkesën e tij brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së saj.

4. Çështjet, të cilat kanë lidhje me rregullimet statutores, kushtet e regjistrimit apo mënyrën e drejtimit të shoqërisë, si dhe çështje të tjera, të cilat trajtohen në kërkesën e anëtarëve që zotërojnë 10 për qind të kapitalit të shoqërisë, përfshihen për shqyrtim e diskutim në rendin e ditës së mbledhjes më të parë të asamblesë së përgjithshme.

5. Anëtari kërkues ka të drejtë të kundërshtojë refuzimin e dhënies së informacionit, duke iu drejtuar gjykatës brenda 30 ditëve nga njoftimi për refuzimin.

Neni 15 Detyrimet e anëtarëve

Anëtarët janë të detyruar të përmbushin detyrimet e parashikuara në ligj e në statut dhe veçanërisht:

- a) të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme;
- b) të zbatojnë marrëveshjet e miratuara nga organet e shoqërisë;
- c) të marrin pjesë në veprimtari që përbëjnë objektin e shoqërisë, sipas përcaktimeve të statuteve, përveçse kur asambleja e përgjithshme, në rast të një shkakut të justifikueshëm, mund të përjashtojë nga ky detyrim anëtarin në masën që i takon dhe sipas rrethanave;
- ç) të ruajnë sekretin për ato çështje dhe të dhëna të shoqërisë, përhapja e të cilave mund të dëmtojë interesat e ligjshëm të saj;
- d) të mos kryejnë veprimtari konkurruese me veprimtarinë e shoqërisë, përveçse kur kjo veprimtari zhvillohet në kuadër të cilësisë së tij si anëtar i shoqërisë dhe objektit të saj dhe të mos bashkëpunojnë me ata që zhvillojnë veprimtari konkurruese në të njëjtin sektor me shoqërinë, me përjashtim të rasteve kur autorizohen formalisht nga asambleja e përgjithshme;
- dh) të marrin pjesë në veprimtaritë e formimit dhe të kualifikimit;
- e) të kryejnë derdhjen e kontributeve të tyre në kapitalin e shoqërisë në mënyrën e parashikuar;
- ë) të përmbushin detyrimet e tjera, që rrjedhin nga ligji dhe statuti.

Neni 16 Largimi i anëtarit

1. Anëtari mund të largohet nga shoqëria:
 - a) vullnetarisht, me anë të dorëheqjes;
 - b) i detyruar, me anë të përjashtimit në rastet e parashikuara në këtë ligj;
 - c) kur, nëse statuti nuk e pengon, transferon pjesën e zotëruar prej tij në kapitalin e shoqërisë të një individ ose person juridik, i cili ka marrë miratimin e asamblesë së përgjithshme për të qenë anëtar;
 - ç) në rast likuidimi, kur anëtari është person juridik;
 - d) në rast falimentimi;
 - dh) në rast vdekjeje;
 - e) në çdo rast tjetër, të përcaktuar në ligj apo në statut.

2. Administratori shprehet me vendim të motivuar për largimin e anëtarit, për secilin prej rasteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, dhe vendimin e marrë ia përcjell për miratim asamblesë së përgjithshme.

3. Largimi i anëtarit dhe çdo veprim, i cili ndryshon kapitalin e nënshkruar apo mënyrën e ndarjes së tij, si rrjedhojë e largimit të anëtarit, duhet të shënohen në regjistrin e anëtarëve, që mbahet nga shoqëria, si dhe të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 17

Largimi vullnetar i anëtarit

1. Anëtari mund të largohet nga shoqëria vullnetarisht, nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim, të cilin ia drejton administratorit, sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në statutin e shoqërisë.

2. Nëse administratori nuk shprehet brenda afatit të parashikuar në statutin e shoqërisë, largimi i anëtarit konsiderohet i padëmshëm.

3. Në statut mund të parashikohet një klauzolë për kompromisin e anëtarit për të mos u larguar vullnetarisht, deri në përmbushjen e një afati të caktuar, i cili mund të lidhet me fundin e vitit financiar ose me të qenit prej më shumë se një viti si anëtar në shoqëri.

Neni 18

Rastet e përjashtimit të anëtarit

1. Anëtari mund të përjashtohet nga shoqëria me vendim të asamblesë së përgjithshme, në rastin kur:

a) ka kryer shkelje të rëndë të detyrave të tij ose ka vepruar në kundërshtim me interesat e shoqërisë;

b) nuk plotëson kriteret për të qenë anëtar, sipas dispozitave të këtij ligji;

c) ka shkelur detyrimet e tij, të përcaktuara në shkronjat “b”, “d”, “e” dhe “ë” të nenit 15 të këtij ligji;

ç) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve ndërmjet anëtarit dhe shoqërisë.

2. Vendimi i largimit nga shoqëria i njoftohet anëtarit, sipas afateve dhe mënyrave të përcaktuara në statut.

3. Anëtari ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë për vendimin e shoqërisë për përjashtimin e tij.

KREU V

ORGANIZIMI I SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR

Neni 19

Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë janë asambleja e përgjithshme dhe administratori.

Neni 20

Asambleja e përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme është organ vendimmarrës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqërisë.

2. Asambleja zgjedh kryetarin dhe sekretarin. Rregullat dhe kriteret për zgjedhjen e tyre, periudha e veprimtarisë dhe procedura e shkarkimit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

3. Asambleja e përgjithshme, përveç sa mund të parashikohet në statut, ka këto kompetenca:

a) vendos drejtimin e politikave ekonomike të shoqërisë;

b) analizon raportin e gjendjes financiare, përfshirë llogaritë vjetore, shpërndarjen e fitimeve, ngarkimin e humbjeve, menaxhimin financiar dhe çështje të tjera të veprimtarisë ekonomike, që çmohen të rëndësishme;

c) emëron dhe shkarkon administratorin/ët, ekspertin/ët kontabël dhe likuiduesin/it, si dhe përcakton masën e shpërblimit të tyre;

ç) miraton zvogëlimin apo zmadhimin e kapitalit;



- d) miraton ndryshime të statutit;
 - dh) vendos për shpërndarjen apo mënyrën e përdorimit të fitimit të shoqërisë, sipas dispozitave të këtij ligji dhe statutit;
 - e) vendos shkrirjen, ndarjen, transformimin apo shpërbërjen e shoqërisë;
 - ë) vendos për ndryshimet e strukturës ekonomike, shoqërore, organizative apo funksionale të shoqërisë;
 - f) vendos për pjesëmarrjen në forma të tjera të bashkëpunimit ekonomik edhe me anë të pjesëmarrjes në kapital, aderimin në organizata me karakter përfaqësues dhe shkëputjen prej tyre;
 - g) miraton pasqyrat financiare, raportet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shoqërisë, raportet e ekspertëve kontabël dhe të likuiduesve;
 - gj) miraton pranimin e anëtarëve të rinj dhe pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e shoqërisë, si dhe largimin apo përjashtimin e tyre;
 - h) kryen detyra dhe çështje të tjera të përcaktuara në ligj apo në statut.
4. Për çështjet që shqyrton, asambleja e përgjithshme merr vendimet përkatëse, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e shoqërisë.

Neni 21

Thirrja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara me ligj, në statut apo sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.
Asambleja e përgjithshme thirret të paktën një herë në vit dhe brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët ose nga anëtarët e përcaktuar sipas pikës 4 të neni 14 të këtij ligji.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim, jo më vonë se 30 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Gjithsesi, në raste urgjente ky afat mund të reduktohet në 15 ditë. Njoftimi duhet të përmbajë:
 - a) emërtimin e shoqërisë, selinë e regjistruar, vendin dhe orën e mbledhjes së asamblesë;
 - b) rendin e ditës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

Neni 22

E drejta e votës

Përveçse kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme.

Neni 23

Përfaqësimi në mbledhje

1. Një anëtar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme nga një anëtar tjetër apo nga një person i tretë, në bazë të një prokure të lëshuar nga anëtari, i cili përfaqësohet.
2. Administratorët nuk mund të veprojnë si përfaqësues të anëtarëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Prokura mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë të tillë që, sipas gjykimit të anëtarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë, të ndryshëm nga ata të anëtarit të përfaqësuar.

Neni 24

Kuorumi dhe marrja e vendimeve

1. Përveç sa përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, në rastin e çështjeve për t'u trajtuar në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sipas pikës 3 të nenit 20 të këtij ligji, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm anëtarët me të drejtë vote, të cilët përfaqësojnë më shumë se 30 për qind të kapitalit të shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, asambleja e përgjithshme miraton vendimet e saj për çështjet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 20 të këtij ligji, me votat e anëtarëve, të cilët përfaqësojnë shumicën e kapitalit të shoqërisë, të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje.

2. Asambleja e përgjithshme miraton vendimet e saj, në përputhje me përcaktimet e shkronjave “ç”, “d”, “e” dhe “ë” të pikës 3 të nenit 20 të këtij ligji, me votat e anëtarëve, të cilët përfaqësojnë tre të katërtat e kapitalit të shoqërisë, të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje. Kur asambleja duhet të vendosë për çështjet, të cilat përcaktohen në shkronjat “ç”, “d”, “e” dhe “ë” të pikës 3 të nenit 20 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm anëtarët me të drejtë vote, të cilët përfaqësojnë më shumë se 50 për qind të kapitalit të shoqërisë.

3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

4. Votimi është i hapur, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut.

Neni 25

Procesverbali i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe nga sekretari.

2. Procesverbali dhe dokumentet e bashkëlidhura duhet të ruhen për një periudhë 5-vjeçare dhe anëtarët mund të kërkojnë kopje të tyre.

Neni 26

Administratori

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose disa persona fizikë si administratorë të shoqërisë për një periudhë të përcaktuar në statut, por e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërsëritjeje.

2. Administratorët kanë këto kompetenca:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë së shoqërisë, duke zbatuar politikat e përcaktuara nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve, të regjistrave dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatitin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqesin këto dokumente asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem informimi dhe vlerësimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas këtij ligji;

e) i raportojnë asamblesë së përgjithshme për zbatimin e orientimeve dhe për realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;

ë) kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.



3. Nëse statuti parashikon më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë ose me kompetenca të ndara sipas statutit.

4. Administratorët detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë realizimit të suksesshëm të objektit të shoqërisë dhe ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita dhe duke konsideruar si të rëndësishëm interesin e shoqërisë dhe të anëtarëve të saj;

c) të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

ç) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

5. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin ose administratorët në çdo moment me shumicë të thjeshtë, pa u trajtuar kjo si ndryshim i statutit sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 24 të këtij ligji. Administratorit, të cilit i ka mbaruar mandati i plotë i emërimit, kryen vetëm ato detyra, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e shoqërisë, deri në emërimin e administratorit të ri.

KREU VI REGJIMI EKONOMIK

Neni 27

Kapitali

1. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kontributet e anëtarëve, të cilat mund të jenë në para ose në natyrë. Kapitali ndahet në pjesë, të cilat zotërohen nga anëtarët dhe përfaqësojnë vlerën e kontributit të tyre në kapital.

2. Kontributet në natyrë duhet të shprehen në vlerë ekonomike, në bazë të një raporti vlerësimi, të bërë nga një ekspert. Nëse nuk mund të arrihet në mirëkuptim për vlerësimin, secili prej anëtarëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera, të kërkuara për regjistrim.

3. Kapitali minimal për krijimin e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor është 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 28

Kontributet e detyrueshme

1. Statuti mund të përcaktojë kontributin e detyrueshëm minimal për t'u nënshkruar nga anëtarët, si dhe përqindjen nga ky kontribut për t'u shlyer në çastin e nënshkrimit të pjesëve. Shuma e kontributeve të detyrueshme minimale nuk duhet të jetë më e vogël se kapitali minimal i përcaktuar në pikën 3 të nenit 27 të këtij ligji.

2. Pjesa e nënshkruar si kontribut në natyrë duhet të shlyhet totalisht në çastin e nënshkrimit të saj.

Neni 29

Ndryshimi i kapitalit

1. Ndryshimi i kapitalit nuk mund të arrijë deri aty sa të jetë më i vogël se kapitali minimal i përcaktuar në pikën 3 të nenit 27 të këtij ligji.

2. Statuti parashikon mënyrat e ndryshimit të kapitalit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 30

Transferimi i pjesës së kapitalit

Pjesa e kapitalit në shoqëri fitohet ose transferohet duke pasur parasysh përcaktimet e nenit 13 të këtij ligji dhe dispozitat e statutit, nëpërmjet:

- a) nënshkrimit të kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) dhurimit;
- c) trashëgimisë, kur të interesuarit kërkojnë të jenë anëtarë. Transferimi i pjesës tek të interesuarit, të cilët gëzojnë cilësinë e trashëgimtarit dhe që kërkojnë të jenë anëtarë, bëhet brenda gjashtë muajve nga vdekja e anëtarit. Në rastet kur nuk përmbushet kushti i sipërpërmendur, ata kanë të drejtë të kërkojnë likuidimin e pjesës përkatëse;
- ç) çdo forme, të parashikuar me ligj.

Neni 31

Rimbursimi i kontributeve

1. Anëtarët, që largohen nga shoqëria, rimbursohen për kontributet e derdhura në kapital.
2. Rimbursimi bëhet pa cenuar vlerën e kapitalit minimal, të përcaktuar në pikën 3 të nenit 27 të këtij ligji, dhe duhet të kryhet brenda jo më vonë se 5 vitesh.
3. Statuti parashikon mënyrën dhe procedurën e rimbursimit të kontributeve.

Neni 32

Fondi i rezervës së detyrueshme

1. Shoqëria krijon fondin e rezervës së detyrueshme, i cili destinohet për konsolidimin dhe garancinë e kapitalit të shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor e të aftësisë paguese të saj dhe është i pandashëm ndërmjet anëtarëve dhe i patransferueshëm, përveç rasteve të parashikuara në nenin 56 të këtij ligji.
2. Fondi i rezervës së detyrueshme krijohet nga derdhja në këtë fond e jo më pak se 15 për qind të fitimit neto, të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, pasi të jenë zbritur humbjet e mbartura, në masën derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me kapitalin e shoqërisë, sipas nenit 27 të këtij ligji.

Neni 33

Fondi i përballimit të riskut

1. Shoqëria krijon fondin e përballimit të riskut, që shërben për përballimin nga shoqëria të rreziqeve apo dëmeve të çfarëdolloj natyre, me të cilat mund të përballet veprimtaria e shoqërisë, përfshirë këtu edhe fenomenet natyrore apo ato dëme dhe risqe, të cilat janë të lidhura me vetë llojin e veprimtarisë ose të produktit.
2. Shoqëria depoziton në fondin e përballimit të riskut një përqindje të fitimit të saj, e cila përcaktohet në statut, por që nuk mund të jetë më pak se 10 për qind e fitimit neto, të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, pasi të jenë zbritur humbjet e mbartura. Ky fond është i pandashëm ndërmjet anëtarëve dhe i patransferueshëm, përveç rasteve të parashikuara në nenin 56 të këtij ligji.

Neni 34

Viti ekonomik dhe përcaktimi i fitimeve

1. Viti ekonomik zgjat dymbëdhjetë muaj, sipas vitit fiskal, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin tatimor dhe atë kontabël në fuqi.
2. Përcaktimi i fitimeve të vitit fiskal realizohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.



Neni 35
Përdorimi i fitimit

Pjesa e fitimeve të realizuara nga veprimtaria e shoqërisë pas depozitimeve, në përputhje me nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, me vendim të asamblesë së përgjithshme mund të depozitohet e tëra ose pjesërisht në fondin e përballimit të riskut ose mund t'u shpërndahet anëtarëve apo të përdoret për fonde apo qëllime të tjera, sipas përcaktimeve të statutit.

Neni 36
Ngarkimi i humbjeve

Në rastet kur veprimtaria e shoqërisë në fund të vitit financiar rezulton me humbje, asambleja e përgjithshme vendos nëse për mbulimin e humbjeve do të përdoret rezerva e detyrueshme apo ato do të mbarten për vitin pasardhës.

KREU VII
DOKUMENTACIONI DHE KONTABILITETI

Neni 37
Dokumentacioni i shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor

1. Shoqëria mban të dhënat e veprimtarisë së saj në:
 - a) regjistrin e anëtarëve;
 - b) regjistrin e vendimeve të organeve të saj;
 - c) regjistrat për veprime financiare dhe kontabël.
2. Mbajtja e regjistrave të shoqërisë është nën përgjegjësinë e administratorëve. Mënyrat dhe afatet e ruajtjes së tyre përcaktohen në statut.

Neni 38
Kontabiliteti dhe llogaritë vjetore

1. Shoqëria mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike, në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar.
2. Administratorët përgatitin raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore, në përputhje me legjislacionin kontabël, të cilat ia paraqesin asamblesë së përgjithshme për miratim.

Neni 39
Auditimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten sipas legjislacionit në fuqi dhe dispozitave për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të përcaktuara në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar.

KREU VIII
REGJISTRIMI I SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUIQËSOR

Neni 40
Regjistrimi i shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

1. Shoqëria e bashkëpunimit bujqësor duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të

Regjistrimit, në përputhje me dispozitat e nenit 22 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

2. Për regjistrimet e tjera të detyrueshme, sipas këtij ligji, aplikimi bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 22 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

3. Rezervimi i emrit bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

4. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërisë bëhet nga administratorët ose personat e autorizuar prej tyre.

5. Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike, që lidhen me pjesëmarrjen në kapital, mund të kryhen, gjithashtu, edhe nga anëtari, të cilit i përket pjesa e kapitalit.

6. Aplikimi dhe forma e dokumenteve shoqëruese përcaktohen në nenin 27 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

7. Forma dhe përmbajtja e akteve, që lëshohen nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe çdo veprim i kryer pranë saj, miratohen me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me propozimin e titullarit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 41

Regjistrimi fillestar

1. Shoqëritë regjistrohen në regjistrin tregtar, duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, sipas këtij ligji, statutit dhe aktit të themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, në aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme, si dhe në aktet e tjera, të nevojshme për themelimin, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Për regjistrimin fillestar të shoqërisë janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) emri;
 - b) forma;
 - c) data e themelimit;
 - ç) të dhënat e identifikimit të anëtarëve;
 - d) selia;
 - dh) objekti, në qoftë se është i përcaktuar;
 - e) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
 - ë) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre;
 - f) specifikimet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve;
 - g) njoftimi i vlerës së kapitalit themeltar të nënshkruar;
 - gj) numri i pjesëve të kapitalit;
 - h) vlera e secilës pjesë të zotëruar;
 - i) pjesëmarrja në kapital;
 - j) vlera dhe lloji i kontributeve të secilit anëtar;
 - k) informacioni nëse kapitali fillestar i nënshkruar është paguar ose jo.
3. Vërtetimi i shlyerjes së kapitalit themeltar nuk përbën kusht për regjistrimin fillestar.

Neni 42

Regjistrimet e tjera

1. Çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër, sipas neneve të këtij kreu, njoftohet dhe regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.



2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse si më poshtë:

- a) bilancin vjetor kontabël dhe raportin e miratuar të ekspertëve kontabël, të mbajtur sipas dispozitave të legjislacionit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;
- b) aktin e emërimit dhe të shkarkimit të ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe të dhënat e identifikimit;
- c) aktin e emërimit të likuiduesve, si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;
- ç) aktin e pushimit të veprimtarisë ekonomike tregtare, aktet e prishjes, të mbylljes apo të shpërndarjes, aktet e transformimit, të bashkimit, të ndarjes, të hapjes së procedurave të administrimit, të likuidimit ose të riorganizimit, si dhe aktet e tjera të ndërmjetme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
- d) të dhëna për vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;
- dh) çdo ndryshim të numrit të anëtarëve dhe të kapitalit;
- e) dokumentet, që vërtetojnë vënien e pengjeve, ose garancitë e tjera për pjesëmarrjet në kapitalin e subjektit;
- ë) çdo regjistrim tjetër të detyrueshëm, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 43 **Çregjistrimi**

Çregjistrimi i shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit bëhet në rastet dhe sipas mënyrës së parashikuar nga ky ligj dhe ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

KREU IX SHKRIRJA, NDARJA DHE PRISHJA E SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR

Neni 44 **Shkrirja, ndarja dhe prishja e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor**

Shkrirja, ndarja dhe prishja e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor bëhen në përputhje me dispozitat e pjesës IX të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për aq sa përputhen me dispozitat e këtij ligji.

Neni 45 **Prishja e shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor**

Shoqëria shkrihet dhe hyn në proces likuidimi për shkaqet e mëposhtme:

- a) përfundimi i afatit të shoqërisë, sipas përcaktimeve të statutit;
- b) vullneti i anëtarëve, i manifestuar nëpërmjet vendimit të asamblesë së përgjithshme;
- c) përmbushja e plotë e objektit të shoqërisë ose pamundësia për ta përmbushur atë;
- ç) zvogëlimi i numrit të anëtarëve nën minimumin ligjor të nevojshëm, për të krijuar një shoqëri, sipas dispozitave të këtij ligji, nëse numri i nevojshëm i anëtarëve nuk rivendoset brenda një periudhe prej 6 muajsh;
- d) bllokimi i veprimtarisë vendimmarrëse të ndonjërit prej organeve të shoqërisë ose mosushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare;
- dh) reduktimi i kapitalit të shoqërisë nën minimumin e përcaktuar në ligj, nëse nuk rivendoset brenda një periudhe gjashtëmuajore;
- e) nisja e procedurave të falimentimit;
- ë) mosushtrimi i veprimtarisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare dhe mosnjoftimi i pezullimit të veprimtarisë, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

- f) nëse shoqëria rezulton me humbje për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare;
- g) me vendim të gjykatës;
- gj) për çdo arsye tjetër, të përcaktuar në këtë ligj ose në statut.

Neni 46

Regjistrimi i prishjes

1. Administratorët janë të detyruar të regjistrojnë vendimin për prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
2. Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për vendimin dhe kërkon zbatimin e tij.

Neni 47

Likuidimi

1. Përveç rasteve kur kundrejt shoqërisë është hapur një procedurë falimentimi të personit juridik, sipas dispozitave të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, verifikimi i një prej shkaqeve të përmendura në nenin 45 të këtij ligji, ka si pasojë hapjen e fazës së likuidimit të shoqërisë në gjendjen e aftësisë paguese.
2. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas vendimit të prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë t’i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër.
4. Çdo person i interesuar ka të drejtë t’i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit të emëruar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.
5. Likuiduesi emërohet nga gjykata në rastet kur shoqëria prishet me vendim të gjykatës.

Neni 48

Shkarkimi i likuiduesve

1. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.
2. Paditë, që lidhen me shpërblimin e likuiduesit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 49

Regjistrimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

1. Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse, sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
2. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
3. Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënimi “në likuidim”.



Neni 50
Ftesa për kreditorët

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj, në përputhje me dispozitat e nenit 195 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 51
Administrimi nga likuiduesit

1. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.
2. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri - tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.
3. Likuiduesi i nënshtrohet mbikëqyrjes së anëtarëve dhe të asamblesë së përgjithshme.

Neni 52
Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, likuidimi i të gjitha aseteve të shoqërisë, përfshirë, nëse është nevoja, edhe fondet e krijuara sipas këtij ligji, me qëllim shlyerjen e kreditorëve, duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Nëse, në bazë të pretendimeve të ngritura nga kreditorët sipas nenit 50 të këtij ligji, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Neni 53
Bilancet

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes financiare dhe të aseteve të shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 54
Mbrojtja e kreditorëve

1. Likuiduesit nuk mund të shpërndajnë aktivet e mbetura përpara përfundimit të afatit referuar në nenin 199 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
2. Nëse një kreditor i shoqërisë, për të cilin likuiduesi është në dijeni, nuk kërkon të drejtat e tij, shumat përkatëse depozitohen pranë gjykatës, ndërsa mallrat depozitohen në një magazinë me shpenzimet e kreditorit. Rregullat e përgjithshme për kontratën e depozitës janë të zbatueshme.
3. Nëse një detyrim nuk mund të shlyhet menjëherë ose nëse është i debatueshëm, aktivet mund të shpërndahen vetëm nëse kreditorit i është dhënë garanci e përshtatshme.

Neni 55

Raporti i likuiduesit, shpërblimi dhe shkarkimi

1. Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve, likuiduesit i paraqesin asamblesë së përgjithshme një raport për procedurën e likuidimit, për detyrimet e shlyera, si dhe për shpërblimin e tyre.

2. Nëse asambleja e përgjithshme e miraton raportin, likuiduesit lirohen nga detyra dhe përfitojnë shpërblimin e përcaktuar në raport.

3. Nëse raporti nuk miratohet, likuiduesit mund t'i drejtohen gjykatës me kërkesën për ta shkarkuar nga detyra, si pasojë e përmbushjes në mënyrën e duhur të detyrave.

4. Pas shkarkimit të likuiduesit nga gjykata, ai ka të drejtë të përfitojë shpërblimin e përcaktuar në raport.

Neni 56

Shpërndarja e aktiveve të mbetura

1. Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan anëtarëve aktivet e mbetura, përfshirë edhe fondet e krijuara sipas këtij ligji, në përpjesëtim me veprimtarinë e bashkëpunimit të ndërsjellë, të zhvilluar nga secili anëtar.

2. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim me çfarëdo titulli, u kthehen anëtarëve. Anëtarët nuk kanë të drejtën e dëmshpërblimit në rast shkatërrimi, dëmtimi apo uljeje të vlerës së pasurisë, nëse kjo nuk varet nga veprimi apo mosveprimi i shoqërisë ose personave që kanë vepruar në emër të saj.

Neni 57

Përfundimi i likuidimit dhe çregjistrimi i shoqërisë

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

Neni 58

Përgjegjësia e likuiduesit

1. Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

2. Likuiduesit përgjigjen ndaj kreditorëve për dëmet e shkaktuara gjatë procedurës së likuidimit, në përputhje me dispozitat që rregullojnë përgjegjësinë e administratorëve. Nëse ka disa likuidues, ata përgjigjen bashkërisht. Krahas likuiduesve, edhe anëtarët përgjigjen bashkërisht ndaj kreditorëve të shoqërisë deri në vlerën që u është shpërndarë. Kreditorët, të cilët nuk kanë depozituar pretendimet e tyre në afat, sipas nenit 50 të këtij ligji, apo kreditorët, për të cilët likuiduesi nuk ka qenë dhe nuk mund të kishte qenë në dijeni, nuk kanë të drejtë të ngrënë padi, sipas fjalisë së parë dhe të dytë të kësaj pike.

3. Paditë e përmendura në pikën 2 të këtij neni duhet të ngrihen brenda 3 viteve pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Neni 59

Likuidimi i thjeshtëzuar, kushtet dhe procedura

1. Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përsheptuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë anëtarët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.

2. Administratorët regjistrojnë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.



3. Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, edhe anëtarët e shoqërisë përgjigjen bashkërisht deri në shumat e marra.

4. Paditë, sipas pikës 3 të këtij neni, duhet të ngrihen brenda 3 viteve nga data e çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Neni 60

Fshirja pas likuidimit të thjeshtëzuar

Neni 57 i këtij ligji zbatohet edhe në rastin e përfundimit të likuidimit të thjeshtëzuar.

Neni 61

Federatat e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor

1. Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor mund të bashkohen në federata për të mbrojtur dhe promovuar interesat e tyre.

2. Për themelimin dhe funksionimin e një federate duhet të bashkohen të paktën tri shoqëri të bashkëpunimit bujqësor.

3. Organet e federatës janë asambleja e përgjithshme dhe administratorët.

4. Përbërja, numri, procedurat e funksionimit dhe të organizimit të asamblesë së përgjithshme dhe të administratorëve të federatës përcaktohen në statut.

5. Federata kryen këto detyra:

a) mbron interesat e përgjithshëm të shoqërive anëtare;

b) nxit promovimin, krijimin dhe bashkimin e shoqërive të bashkëpunimit bujqësor;

c) zgjidh konfliktet ndërmjet shoqërive anëtare;

ç) ndërmjetëson dhe përfaqëson shoqëritë me organizatat dhe institucionet shtetërore.

6. Federata duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, duke fituar kështu edhe statusin e personit juridik. Dokumenti publik për themelim duhet të përmbajë:

a) listën e shoqërive anëtare;

b) aktin e marrëveshjes për themelim;

c) organet përfaqësuese dhe drejtuese;

ç) emërtimin;

d) statutin.

7. Në statut përfshihen të dhënat për:

a) emërtimin e federatës;

b) adresën dhe shtrirjen territoriale;

c) kushtet dhe procedurat për anëtarësimin e shoqërive në federatë;

ç) përbërjen, funksionimin dhe zgjedhjen e organeve të saj të përfaqësimit dhe menaxhimit.

8. Për funksionimin e federatës janë të vlefshme dispozitat e këtij ligji për aq sa janë të zbatueshme.

KREU X

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 62

Transformimi i shoqatave të fermerëve dhe shoqërive të bashkëpunimit të ndërsjellë në shoqëri të bashkëpunimit bujqësor

1. Shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe shoqatat e fermerëve, të krijuara sipas legjislacionit në fuqi, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të

transformohen në shoqëri të bashkëpunimit bujqësor, sipas këtij ligji. Ky transformim në shoqëri të bashkëpunimit bujqësor nuk shoqërohet me likuidim të shoqërisë ose shoqatës.

2. Organet drejtuese të shoqërisë ose shoqatave, të cilat do të transformohen, duhet të hartojnë një projekt transformimi dhe një relacion shpjegues të aspekteve juridike dhe ekonomike të këtij transformimi, si dhe të pasojave që do të kenë anëtarët dhe të punësuarit.

3. Asambleja e përgjithshme e shoqërisë ose e shoqatës, e cila do të transformohet, miraton projektin e transformimit dhe statutin e ri të shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor, si dhe bën regjistrimin e ndryshimeve përkatëse në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 63
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.4.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7409, datë 23.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË PROKURIMEVE PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë:

Në vlerësim të rolit të Avokatit të Prokurimeve, si institucioni, i cili mbron të drejtat dhe interesat e ligjshëm të kandidatëve, ofertuesve apo furnizuesve në fushën e prokurimit publik, nëpërmjet monitorimit dhe hetimit të procedurave administrative të prokurimeve publike;

Në mbështetje të veprimtarisë së këtij institucioni të pavarur;

Konstaton se gjatë vitit 2011 Avokati i Prokurimeve:

- Ka rritur nivelin e bashkëpunimit në marrëdhëniet me institucionet e treta, në drejtim të transparencës me publikun, mediat dhe operatorët ekonomikë;

- Ka rritur ndjeshëm edhe bashkëpunimin ndërinstitucional në procedurat prokuruese, koncesionare dhe ankandeve, duke luajtur rol të rëndësishëm në drejtim të parandalimit të veprimeve abuzive;

- Ka kryer hetime administrative të plota, të hollësishme të procedurave të prokurimit të operatorëve ekonomikë dhe, gjithashtu, ka ushtruar një hetim të plotë të gjithë procesit në respektim të legjislacionit në fuqi;

- Ka kryer monitorime të procedurave prokuruese në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të operatorëve ekonomikë;

- Në rastet e konstatimit të shkeljeve ligjore, ka vepruar në zbatim të ligjit me propozime konkrete për marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës të autoriteteve kontraktuese, duke vënë në dijeni njëkohësisht dhe Agjencinë e Prokurimit Publik;

- Ka rritur rolin mbikëqyrës për respektimin nga autoritetet kontraktuese të kuadrit ligjor e nënligjor në fushat e prokurimit publik, koncesioneve dhe ankandit publik.

Kuvendi rekomandon që, për vitin 2012, Avokati i Prokurimeve duhet të konsolidojë më tej punën në këto drejtime kryesore:

- Rritjen e efikasitetit të punës gjatë hetimeve dhe monitorimeve të vazhdueshme dhe të plota të procedurave prokuruese të autoriteteve kontraktuese;

- Vazhdimin e rritjes së transparencës, për të bërë të mundur sigurimin e besimit të publikut në procedurat e prokurimit publik;



- Rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit ndërinstitucional me Agjencinë e Prokurimit Publik, Komisionin e Prokurimit Publik, Kontrollin e Lartë të Shtetit, dhomat e tregtisë dhe institucionet e tjera kombëtare e ndërkombëtare.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

5 prill 2012

DEKRET
Nr. 7379, datë 9.4.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:

Adem Zeqir Demaçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 25.4.2012
Doli nga shtypi më 26.4.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 46 lekë